



RAPORT
(Auditimi Financiar)
“BASHKIA DELVINË”

Tiranë, Korrik 2024

PËRMBAJTJA

I. Përmbledhje ekzekutive	4
1.1 Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	6
II. Hyrja	6
<u>1. Objektivat e auditimit</u>	7
<u>2. Qëllimi i auditimit</u>	7
<u>3. Identifikimi i çështjes</u>	8
<u>4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese</u>	8
<u>5. Përgjegjësitë e audituesve</u>	8
<u>6. Kriteret e vlerësimit</u>	9
<u>7. Standardet e auditimit</u>	9
<u>8. Metodologjia e auditimit</u>	9
<u>9. Dokumentimi i auditimit</u>	9
III. REZULTATET E AUDITIMIT	10
<u>3.1 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.</u>	10
<u>3.2.6 Vlerësimi dhe mbledhjes së të ardhurave</u>	18
<u>2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike- Asetet.</u>	23
<u>2.7 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme</u>	38
IV GJETJE DHE REKOMANDIME	50
<u>ANEKSET</u>	60

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ushtroi auditim financiar dhe përputhshmërie në Bashkinë Delvinë, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e implementimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, veprimtarisë së sektorit të auditimit të brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, transaksioneve financiare dhe ngjarjeve ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, planifikimit, realizimit të prokurimeve dhe zbatimit të kontratave të lidhura për punë publike, planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit, aktivitetin e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, si dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Gjatë periudhës së auditimit nga data 08.04.2024 deri në datën 03.05.2024 u krye auditimi, i cili kishte objekt: “Auditimin Financiar të Bashkisë Delvinë” dhe mbuloi periudhën nga data 01.01.2023 deri më datë 31.12.2023.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, janë mbajtur gjithsej 3 akt-konstatime dhe 1 akt-verifikim. Mbi aktet e mbajtura nga grupi i auditimit, nga subjekti i audituar, janë paraqitur observacionet, të cilat janë reflektuar rast pas rasti në mënyrë të përmbledhur.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: *“1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njërive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”*. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Delvinë si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Delvinë. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.
- mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodot e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. **Nga shqyrtimi i evidencave**, rezultoi se institucioni për periudhën nënauditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 10 gjetje dhe ka dhënë 10 rekomandime, nga ku masa organizative me 7 gjetje dhe 7 rekomandime si dhe 3 gjetje-rekomandime në vlerën **68,823 mijë lekë** në fushën e të ardhurave.

f. **Paraqitja e gjetjeve kryesore.** Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

-Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave

- Të ardhura të munguara në vlerën **68,016 mijë lekë** nga mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga debitorë e biznesit, institucioneve dhe familjare.

- Të ardhura të munguara në vlerën **807 mijë lekë** nga mos arkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga 25 persona debitorë.

▪ Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe regjistrimin e asetëve

Nga auditimi rezultoi se, janë 664 të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, të transferuara në pronësi ose në përdorim Bashkisë Delvinë (Qendër) me VKM. Referuar Ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” është bërë një inventarizim i plotë i të gjitha pronave që i janë transferuar organeve të pushtetit vendor duke saktësuar të dhënat mbi këto prona, ku sipas inventarizimit faktik rezultuan 664 prona.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Kryetari i Bashkisë Delvinë dhe Sektori i Financës, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore,

Titullari i Bashkisë Delvinë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për identifikimin e gjendjes dhe numrit të asetëve të cilat i janë transferuar në pronësi në mënyrë përfundimtare, si dhe të fillohet përgatitja e dokumentacionit tekniko ligjor të secilit prej tyre për të vijuar me aplikimet përkatëse për pajisje me çertifikatë pronësie.

Sektori i Taksave, Tarifave, Lejeve dhe Licensave në Bashkinë Delvinë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifatat vendore në fund të vitit 2023 në vlerën 68,016,302 lekë.

Bashkia Delvinë të marrë masa të nxjerrë në shitje aksionet që zotëron në shoqërinë “Klubi i Futbollit Delvina”, sha në përputhje me parashikimet e ligjore “Për sportin”.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

A. OPINIONI I AUDITIMIT

I.Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2023

a.-Opinion i pamodifikuar, me “Theksim çështjeje”¹:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Delvinë, për vitin ushtrimor 2023, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumatat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinioni:

¹ **Opinion i pamodifikuar me theksim çështjeje.** Në rrethana të caktuara, audituesi mund të marrë në konsideratë faktin se lexuesi nuk do të arrijë në kuptimin e saktë të pasqyrave financiare nëse atij nuk do t'i tërhiqet vëmendja mbi çështjet të pazakonta ose të rëndësishme. Si parim i përgjithshëm, audituesi nuk i referohet aspekteve specifike të pasqyrave financiare kur jep një opinion të pamodifikuar, në rast se kjo ndodh mund të keqinterpretohet si modifikim. Për të evituar dhënien e kësaj përshtypje të gabuar, referencat e menuara si “theksimi i çështjes” përfshihen në një paragraf të veçantë nga ai i opinionit.

Sipas mendimit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705², dhe ISSAI 1200³, pasqyrat financiare veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike, përfshirë rregullat për prokurimet dhe ato të buxhetit. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi “Theksimi i Çështjes”.

Baza për opinionin e pamodifikuar, me Theksim çështjeje:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Delvinë, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISA 700). Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të pakualifikuar të auditimit. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej **4,103 mijë lekë** si dhe anomalitë e konstatuara, si vijon:

Theksimi i çështjeve:

- Llogaria 26 “Aktive afatgjata financiare”, është nënvlerësuar për vlerën **46,500 mijë lekë**, në fund të vitit 2023;
- Llogaria 215 “Mjete transporti” është mbivlerësuar për vlerën **6,702 mijë lekë**, në fund të vitit 2023;

I. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 432/1 Prot, datë 03.04.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 08.04.2024 deri në datën 03.05.2024, në subjektin Bashkia Delvinë u krye “Auditimi Financiar” për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

- 1.H.I– Përgjegjës Grupi
- 2.K.F– Anëtar

1. Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Delvinë kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)⁴;

² Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

³ Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi

⁴Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Delvinë është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Delvinë dhe përgjegjësisë, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
2. Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2023.
3. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Delvinë, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Delvinë është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kritereve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Delvinë. Burimet e kritereve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji Nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- “VKM nr. 187, datë 8.3.2017 për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, i ndryshuar.
- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”;
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- Udhëzimi i MFE nr. 10, datë 28.02.2020 “Për përgatitjen e PBA vendor 2021-2023”;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 ”Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Delvinë grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë :

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik“;
- ISSAI 200 “Parimet themelore të auditimit financiar”.
- ISSAI 2200-2899 "Standardet e auditimit financiar";
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

8. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Delvinë me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale⁵. Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH^{ja} aplikon⁶.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e

⁵ ISSAI 1315

⁶ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

dokumente në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektive fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësive shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

1. Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.

1.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor 2023;

1.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura;

1.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

1.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MFE, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.).

1.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

1.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2023;

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2023-2025, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, është bërë ngritja e grupit të punës, është bërë marrja e kërkesave për nevojat për punë, mallra e shërbime, llogaritja e planifikimit për të ardhurat e veta, përcaktimi i tavaneve të shpenzimeve sipas programeve, etj. Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë etj, gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare. Me Urdhrin nr. 271/1, datë 08.02.2022, ndryshuar me Urdhrin nr. 2134, datë 23.09.2022 është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023- 2025. Planifikimi i programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, me nr. 59 datë 22.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Delvinë për vitin 2023 dhe buxhetin afatmesëm për periudhën 2023-2025”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr.2/1 prot., datë 11.01.2023. PBA (faza fillestare dhe përfundimtare) janë miratuar në Këshillin Bashkiak me vendimet:

a-PBA 2023-2025 miratuar respektivisht me VKB nr. 31 , datë 19/07/2022 me VKB nr. 41, datë 26/09/2022. Viti i parë i PBA është njëkohësisht edhe vit buxhetor vjetor.

Gjatë hartimit të PBA, 2023-2025 janë përcaktuar “Përshkrimi i çdo programi”; “Politikat e programit”; “Qëllimi Politikës së programit”; “Objektivat e politikës së programit”.

PBA	Urdhëratë GMS		Urdhëratë EMP		VKB			Nr.	shënime
	Nr.	Datë	Nr.	Datë	Objekti	Nr.	Datë	Programe	
2023-2025	271/1 2134	08.02.2022 23.09.2022	271/1 2134	08.02.2022 23.09.2022	miratim kalendari	-	-	12	
					miratim tavaneve të shpenzimeve	11	05.04.2022	12	në afat
					miratimi i tabelave të PBA	31	19.07.2022	12	në afat

Burimi: Drejtoria e Financës

Miratimi i tavaneve të buxhetit afatmesëm 2023-2025Vendim i Këshillit Bashkiak nr.11, datë 05.04.2022, brenda afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37.

Vendimi i Këshillit Bashkiak me nr. 59 datë 22.12.2022, “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Delvinë për vitet 2023-2025”,ëë jo më vonë se 31 Janar, brenda afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 34. Për vitin 2023, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr. 59 datë 22/12/2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 2/1 prot, datë 11.01.2023.Në këtë VKB, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2023 kanë vlerën 54,249,000 lekë, transfertat e pakushtëzuar ka vlerën 77,980,030 lekë, transfertat specifike ka vlerën 61,097,090 lekë,fondet e trashëguara nga viti 2022 ka vlerën 19,500,880 lekë. Në total të ardhurat kanë vlerën 212,827,000 lekë, po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën 212,827,000 lekë. Gjatë vitit 2023, Bashkia Delvinë me VKB nr.7,datë 28.02.2022 “Për miratim te disa shtesa dhe ndryshime në Buxhetin e Bashkisë Delvinë për vitin 2022”, shprehur ligjshmëria nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 245/1 prot, datë 15.03.2023,VKB nr.10 datë 18.04.2023 “Për miratimin e disa shtesave në Buxhetin e Bashkisë Delvinë për vitin 2023”, shprehur ligjshmëria nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 421/1 prot, date 03.05.2023,VKB nr.12 date 31.05.2023 “Për miratimin e disa shtesave në Buxhetin e Bashkisë Delvinë për vitin 2023”, shprehur ligjshmëria nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 544/1 prot, date 06.06.2023,VKB nr.21 date 21.07.2023 “Për disa shtesave dhe rishpërndarje në Buxhetin e Bashkisë Delvinë për vitin 2023”, shprehur ligjshmëria nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 701/1 prot, date 31.07.2023,VKB nr.31 date 28.08.2023 “Për një shtesë dhe disa rishpërndarje në Buxhetin e Bashkisë Delvinë për vitin 2023”, shprehur ligjshmëria nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 808/1 prot, date 13.09.2023,VKB nr.37 date 06.11.2023 “Për një shtesë dhe rishpërndarje në Buxhetin e Bashkisë Delvinë për vitin 2023”, shprehur ligjshmëria nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 972/1 prot, date 07.11.2023,VKB nr.44 date 22.12.2023 “Për një shtesë në Buxhetin e Bashkisë Delvinë për vitin 2023”, shprehur ligjshmëria nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 2/1/1 prot, date 10.01.2024,ka ndryshuar vlerat e buxhetit bazë (miratuar në dhjetorë 2022). Këto ndryshime paraqiten si vijon:

-Janë alokuar fondet e trashëguara nga viti 2022, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 13,585,289 lekë;

-Janë alokuar fonde shtesë transferte specifike për arsimit parashkollor nga ministria e linjës, për efekt të mbulimit të shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore si efekt rritjes së pagës minimale në vlerën 2,227,718 lekë;

-Janë alokuar fonde shtesë transferte e pakushtëzuar, për efekt të mbulimit të shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore si efekt rritjes së pagës minimale në vlerën 7,450,128 lekë

Janë aokuar fonde për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën 9,451,737 lekë.

Janë alokuar fonde shtesë të ardhura nga burimet e veta në vlerën 8,268,000 lekë.

Buxheti i miratuar për vitin 2023 është 253,811 mijë lekë, me burime financimi si me poshtë:

1- Të ardhurat e veta 65,873 mijë lekë (26%) të totalit të burimeve

2- Transferte të pakushtëzuar e përgjithshme 107,760 mijë lekë (42.4%) të totalit

3- Transferte të pakushtëzuar sektoriale 80,178 mijë lekë (31.6%) të totalit

Të marra së bashku trasfertat nga qeveria qendrore janë 187,938 mijë lekë dhe zënë 74% të totalit të burimeve financiare.

Buxheti i miratuar është dërguar në Degën e Thesarit brenda afatit ligjor .

Më të detajuar burimet dhe shpenzimet e planifikuara paraqiten në tabelën si vijon:

në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2023 ne leke	
		Ardhurat	Shpenzimet
1	Të ardhura të trashëguara viti 2022	3,355	0
2	Plani i të ardhurave viti 2023	62,518	0
3	Trashëguar nga transfertat viti 2022	12,878	0
4	Transferte të pakushtëzuar viti 2023	94,882	0
5	Transferte të specifike viti 2022	16,853	0
	Transferte të pakushtëzuar sektoriale viti 2023	63,325	0
1	Paga (600)	0	127,036
2	Sigurime shoqërore (601)	0	22,607
3	Shpenzime operative (602)	0	65,212
4	Transferta (603+604+605+606+609)	0	2,100
5	Investime (230 +231) nga buxheti i Bashkisë	0	36,852
	Totali i buxhetit	253,811	253,811

Burimi: Drejtoria e financës

Në formë table paraqitet planifikimi bazë i buxhetit për vitin 2023 dhe ndryshimet në tabelën vijuese:

në mijë lekë

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2022	Faza e I PBA 2023	Faza e II PBA 2023	Buxhet faktik 2023
600	Paga	97,212	125,482	125,482	127,036
601	Sigurime Shoqërore	16,048	21,192	21,192	22,607
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	39,224	54,113	54,113	65,216
604	Transferta Korente të brendshme	1,470	2,100	2,100	2,100
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0	0	0	0
I	Shpenzime Korrente	153,953	202,887	202,887	216,959
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	15,714	9,940	9,940	36,852
	Shp. Kapitale me financim te brendshëm	15,714	9,940	9,940	36,852
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0
II	Shpenzime Kapitale	15,714	9,940	9,940	36,852
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashtë limiti	0			0
	I+II +III Totali I Shpenzimeve	169,667	212,827	212,827	253,811

Burimi: Drejtoria e financës

Gjatë vitit 2023 është bërë Analiza dhe monitorimi i buxhetit çdo 4-mujore, Raportet e monitorimit janë diskutuar dhe miratuar në Këshillin Bashkiak, dhe janë dërguar në ministrin e financave ëbrenda afateve ligjore.

Ky raportim monitorimi për vitin 2023 është miratuar në Këshillin Bashkiak dhe është dërguar në Ministrin e Financave. Konkretisht është hartuar raporti i monitorimit dhe i performances për vitin 2023 dhe është dërguar në ministrin e Financave me shkresë nr.490, date 29/02/2024.

1.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

-Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2023-2025 me planin buxhetor 2023, paraqitet në tabelën e më poshtme:

në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Plan përfundim 2023	Sipas PBA 2023-2025	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) ardhur e granti pakkush e spec)	139,966	146,675	-6,709
2	Shpenzime (602.604.609) (ardhura e grantipakushtez e specif)	67,316	56,213	+11,103
3	Investime Bashkia (nga te ardhura e granti pakushtez)	27,401	9,950	+17,451
	Total I planit fillestar	234,683	212,828	
	Shtesat nga Pushteti Qendror	19,128		+19,128
5	Investime grant i pakushtëzuar detyrime të prapambetura	9,451		+9,451
6	Shpenzime për pagat (600+601)	9,677		+9,677
7	Shpenzime (602.604.609)	0		
	Gjithsej	253,811	212,828	+40,893

Burimi: Drejtoria e financës

Nga auditimi konstatohet se nga krahasimi i planit përfundimtar të vitit 2023 me atë të PBA-së 2023-2025, rezulton se rritja e planit përfundimtar është në vlerën 40,893 mijë lekë respektivisht: vlera 2,968 mijë lekë i përket shpenzimeve për paga e sigurime; vlera 11,103 mijë lekë i përket shpenzimeve operative, dhe vlerës prej 26,912 mijë lekë i përket investimeve të vitit dhe detyrimeve prapambetura të viteve të kaluara duke dhënë efekt në uljen e borxhit të keq.

Lista e investimeve të reja parashikuar në buxhetin vjetor të vitit 2023 nga të ardhurat e veta dhe granti.

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi i investimit	Nr. dhe data e VKB	Burimi financimit	Vlera e miratuar në VKB	Vlera e realizuar e investimit (me TVSh)
1	Blerje banesash sociale	Nr.59,datë 22/12/2022	Transferta e pakushtëzuar	1,500	0
2	Blerje automjeti zjarrfikës	Nr.59,datë 22/12/2022	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	2,200	0
	Blerje automjeti zjarrfikës	Nr.12,datë 31/05/2023	Transferta e pakushtëzuar	1,000	0
3	Rikonstruksion kanaleve vaditëse	Nr.59,datë 22/12/2022	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	6,000	0
4	Aredim kopshti me drekë për fëmijë	Nr.59,datë 22/12/2022	Të ardhurat e veta	120	0
5	Blerje pajisje kompjuterike	Nr.37,datë 06/11/2023	Të ardhurat e veta	300	0
6	Blerje mjet tip skrep	Nr.37,datë 06/11/2023	Të ardhurat e veta	3,500	0
7	Rikonstruksioni katit të trete Pallatit Kultures	Nr.37,datë 06/11/2023	Të ardhurat e veta	1,500	1,212
8	Krijim laborator kompjuterik për "Qendra Multifunkionale për shterret në nevojë"	Nr.37,datë 06/11/2023	Të ardhurat e veta	145	143
	Total nga granti+të ardhura			16,265	1,355

Burimi: Drejtoria e financës

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të graveve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të graveve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, graveve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Gjatë viteve janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/ paksime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit në mbështetje të Udhëzimit nr.9 dt.20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit" pika 100 germa "b" dhe "c" ndërmjet zërave të shpenzimeve kapitale, brenda të njëjtit program, miratohen nga

Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

-Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

-Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

-Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Janë kryer ndryshime dhe shtesa në buxhetin vjetor, ndryshime për efekt të përmirësimit të situatës financiare për ulje të borxhit të keq dhe shtesat e diktuar nga pushteti qendror. Tabela e ndryshimeve në buxhet paraqitet në vijim:

në mijë lekë

Periudha buxhetore	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjate viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve			
	Nr./ datë	Vlera	Nr./ datë	Vlera	Pakësuar artik (me emër)/ shtuar artikull			
					Shtesa art.	shuma	Paksime	shuma
Viti 2023	Nr.59, dt.22/12/2022	212,828	Nr.7, dt.28.02.2023	13,585	600+601,Paga dhe sigurime.	753		
					602- 609ShP. te tjera	11,332		
					230+231 (Investime)	1,500		
			Nr.10, dt.18.04.2023	6,624	602(shpenzime operative)	5,500		
					230+231 (Investime)	1,124		
			Nr.12, dt.03.05.2023.	2,228	600+601,Paga dhe sigurime	2,228		
			Nr.21, dt.21.07.2023.	7,450	600+601,Paga dhe sigurime	7450		
			Nr.31, dt.28.08.2023	1,650	230+231 (Investime)	1,650		
			Nr.44, dt.22.12.2023	9,452	230+231 (Investime)	9,452		

Burimi: Bashkia Delvinë

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit viti 2023, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

në mijë lekë

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Delvinë, për vitin 2023, në mijë lekë(pa transfertat e kushtëzuara dhe fondet e deleguara)						
Nr.	Përshkrimi i shpenzimeve	Plani 2023	Fakti 2023	Realizimi në %	Vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta	Vlera e mbuluar nga FZHR dhe granti
	Bashkia pa njësitë vartëse					
1	Artikulli - 600 Paga	119.825	111.900	93.89	15.797	96.103
2	Artikulli - 601Sig. shoqërore &shend	22.387	18.505	82.66	64	18.441
3	Artikulli - 602 Shpenzime operative	59.744	37.249	62.35	13.902	23.347
4	Artikulli – 604-606 Transferta korrente te brendshme	2.020	520	25.74	520	0
5	Artikulli - 606 Transferime tek buxhetet familjare (Ndhma ek. dhe PAK)	0	0	0	0	0
6	Artikulli - 230 Projekte	0	0	0	0	0
7	Artikulli - 231 Investime	31.831	20.673	64.95	10.737	9.936

TOTAL viti 2023		235.807	188.847	80.09	41.020	147.827
Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Delvinë, për vitin 2023, në mijë lekë(me transfertat e kushtëzuara dhe fondet e deleguara)						
Nr.	Përshkrimi i shpenzimeve	Plani 2023	Fakti 2023	Realizimi në %	Vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta	Vlera e mbuluar nga FZHR dhe granti
Bashkia pa njësitë vartëse						
1	Artikulli - 600 Paga	121.871	115.157	94	15.797	99.360
2	Artikulli - 601 Sig. shoqërore & shend	22.825	18.890	83	64	18.826
3	Artikulli - 602 Shpenzime operative	61.515	39.127	63.6	13.902	25.225
4	Artikulli - 604 Transferta korrente te brendshme	2.623	2.622	100	520	2.102
5	Artikulli - 606 Transferime tek buxhetet familjare (Ndhma ek. dhe PAK)	89.416	85.493	95.6	0	85.493
6	Artikulli - 230 Projekte	0	0	0	0	0
7	Artikulli - 231 Investime	43.850	32.357	74	10.737	21.620
TOTAL viti 2023		342.100	293.646	85.83	41.020	252.626

Konstatohet se plani i buxhetit i gjeneruar nga thesari ka vlerën **235,807 mijë lekë** i barabarte me vlerën e planit të buxhetit të miratuar nga këshilli bashkiak që ka vlerën **235,807 mijë lekë**. Planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve (të ardhurat e veta vendore, transfertat e pa kushtëzuar, si dhe granti) ka vlerën **235,807 mijë lekë**, ndërsa realizimi **188,847 mijë lekë**, ose në masën 80,09%. Zëri shpenzime pagë është planifikuar në vlerën **119,825 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **111,900 mijë lekë**, ose në masën 93.89%, ndërsa zëri sigurime shoqërore është realizuar në masën 82.66%. Zëri shpenzime operative është planifikuar në vlerën **59,744 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **37,249 mijë lekë**, ose në masën 62.35 %. Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën **31,831 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **20,673 mijë lekë**, ose në masën 64.95 %.

Konkluzion: Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2023 me të ardhurat e veta (pa transfertën e kushtëzuar) të Bashkisë Delvinë ka diferencë me vlerën e planifikuar.

Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën **235,807 mijë lekë**, ndërsa realizimi **188,847 mijë lekë**, ose në masën 80.09%. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën **31,831 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **20,673 mijë lekë**, ose në masën 64.95 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Delvinë në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe ngarkojnë me përgjegjësi znj.E J, me detyrë Drejtoreshë e Financës.

Gjithashtu rezulton se gjatë vitit 2023 është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2022. Veprimet e mësipërme janë në përputhje me Neni 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ku thuhet:

“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji”.

Nga auditimi i shpenzimeve të kryera nga llogaria 602 konstatohet se është kaluar edhe kontributi për shoqëritë tregtare për Klubin Shumësportësh në vlerën 6,000 mijë lekë për gjithë vitin 2023 miratuar me vendimin nr. 59 datë 22.12.2022. Ky kontribut lind nga zotërimi i aksioneve që Bashkia Delvinë ka në këtë shoqëri.

Rezultoi se Bashkia Delvinë nuk ka filluar procedurat për shitjen e aksioneve të shoqërisë “Klubi i Futbollit Delvina” sha në përputhje me ligjin nr. 105/2020, datë 29.07.2020 “Për Sportin”, neni 8 ku citohet “*Institucionet publike qendrore dhe vendore, që kanë në zotërim aksione të shoqërive tregtare sportive, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji i nxjerrin ato në shitje në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.*”. Nga mos zbatimi i këtij ligji, nga Bashkia Delvinë është vijuar me planifikimin dhe kryerjen e pagesave si kontribut në vlerë totale 6,000 mijë lekë ndaj “Klub Futbolli Delvina”, që përbën shpenzim pa ekonomikitet i fondeve të buxhetit të shtetit. Veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 105/2020 , datë 29.07.2020 “Për Sportin”, neni 8, Ligji 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor, në RSH”, neni 6, 10.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës dhe emergjencë

Konstatohet se me VKB nr. 59 datë 22/12/2022 është miratuar buxheti i vitit 2023 ku është përcaktuar edhe fondi rezervë (fondi i veçantë) në vlerën 1,000,000 lekë. Ky fond nuk është përdorur gjatë vitit 2023.

2.4.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimeve gjyqësore, vendimeve të shpronësimit dhe niveli i realizmit të të ardhurave (faturat e pa likujduara të shoqërohen me listë analitike të detajuar me nr. fature, datë krijimi etj., sipas raportimit në MFE) Në mënyrë të përmbledhur paraqitet fondet e trashëguara për vitin 2023.

Fondet e trashëguara në 31.12.2022 për përdorim në vitin 2022 sipas rakordimit me thesarin (Llog. 520 në bilanc pa pjesën e llog 466)	Fondet e trashëguara në 31.12.2023 për përdorim në vitin 2023 sipas rakordimit me thesarin (Llog. 520 në bilanc pa pjesën e llog 466)
33,086,790	46,959,830

Detyrimet e prapambetura viti 2023

në mijë lekë

Emërimi i detyrimit të prapamb.	Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2022	Vlera e paguar gjatë vitit 2023 për detyrimin e prapambetur (vlera e paguar për kolonën 3)	Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2023 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2023)	Detyrim iprapambetur i krijuar vetëm gjatë vitit 2023 (situata më 31.12.2023)	Vlera totale e detyrimeve të prapambetur pa më 31.12.2023
2	3	4	5=3-4	6	7=5+6
Shpenzime gjyqësore	1,247	0	1,247	0	1,247
Fatura te palikujduara për shërbime	1,483	0	1,483	623	2,106
Fatura te palikujduara për mallra	3,305	1,202	2,103	87	2,190
Fatura te palikujduara për investime	42,987	18,834	24,153	3,057	27,210
Totali	49,022	20,036	28,986	3,767	32,753

Burimi: Bashkia Delvinë

Vlera e raportuar nga Bashkia Delvinë në MF për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2023 është **32,753,302 lekë**, konfirmuar me shkresën nr. 309 prot., datë 06.02.2024 dërguar Ministrisë së Financave; Drejtorisë së përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit Publik dhe Drejtorisë së

Financave Vendore. Stoku i detyrimit të mbetur rakordon me vlerën e detyrimeve në sistemin e thesarit si vijon:

Stoku i detyrimit të mbetur rakordoon me vlerën e detyrimeve në sistemin e thesarit si vijon

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua sfatgjatë	0		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve	0		
II	Detyrime (a+b+c)			11.72%
a	Shpenzime korrente	4,296,232		
a,1	Mallra dhe shërbime	4,296,232		
a,2	Paga dhe sigurime			
a,3	Të tjera			
b	Shenzime kapitale	27,210,432		
b,1	Insitucione buxhetore			
b,2	Subjekte private	27,210,432		
c	Vendime gjyqësore	1,246,638		
c,1	Marrëdhënie pune			
c,2	Mallra dhe shërbime			
c,3	Investime			
c,4	Të tjera	1,246,638		
III	Totali (I+II)	32,753,302	279,432,108	11.72%

Burimi: Bashkia Delvinë

Bashkia Delvinë në datën 01.01.2023 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 49,022 mijë lekë e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Në planin e buxhetit vjetor 2023 është planifikuar për likuidim gjatë këtij viti vlera 5,501 mijë lekë, nga e cila është likuiduar vlera 20,035 mijë lekë, ose 364% e vlerës së planifikuar. Vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2023), është ulur (49,022-32,753), me 16,268 lekë, ose në masën prej 33%.

Për sa më sipër rezulton se marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. Për mos marrjen e masave të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe krijimi i detyrimeve të reja për vitin 2023 paraqiten në aneksin nr. 1 pika 1.4 bashkëlidhur raportit të auditit.

(Sa më sipër subjekti i audituar nuk ka paraqitur observacion mbi konstatimet e Grupit të auditimit deri në këtë fazë)

2.6. “Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor. u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Pasqyrat në lidhje me arkëtimet e të ardhurave nga subjektet, familjarët, taksat e tokës, etj;
- Dokumentacioni i sektorit të taksave dhe tarifave vendore në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave të tatim-paguesve, shkarkime nga Programi Excel i mbajtjes së taksave. Evidencat e debitorëve për bizneset dhe familjarët, për taksat dhe tarifave vendore;

- Akt-rakordimet me degën e Thesarit dhe raportimet mbi realizimin faktik të të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e tatim-taksave.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar u konstatua:

➤ **Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore**

Për vitin 2023 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me urdhër të kryetarit të bashkisë nr. 129 datë 24.01.2023, e ndryshuar si dhe miratuar me VKB nr. 59, datë 22.12.2022, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Delvinë për vitin 2023”, ku përfshihet edhe struktura e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore e përbëre nga 5 punonjës: ku 4 janë specialistë të vlerësimit të taksave dhe tarifave të biznesit, 1 specialist për lejet dhe licencat, respektivisht paraqitet në aneksin nr. 1 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Delvinë kryhet në programin Excel. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore gjithashtu kryen edhe regjistrim manual të të dhënave (regjistra fizik) dhe të çdo informacioni lidhur me subjektet apo familjet objekt i taksave dhe tarifave vendore.

Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Delvinë 2022-2023

Nr.	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrime të reja	Mbyllur Aktivit	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi Vogël	2022	191	1	5	187
		2023	192	5	7	190
2	Biznesi Madh	2022	32	0	0	32
		2023	32	1	0	33
(1+2)	Gjithsej	2022	223	1	5	224
		2023	224	6	7	223

Burimi: Bashkia Delvinë

Sa më sipër konstatohet se numri total i bizneseve në Bashkinë Delvinë ka ardhur në rritje nga viti 2022 që rezultojnë 224 në vitin 2023 rezultojnë 223 biznese gjithsej. Për këtë periudhë janë regjistruar 6 biznese të reja ndërkohë që janë mbyllur 7 biznese të tjera.

Nga auditimi rezulton se në Bashkinë Delvinë, ka funksionuar Sektori i Taksave, Tarifave, Lejeve dhe Licensave në Bashkinë Delvinë. Paketat fiskale për vitin 2023 është miratuar me Vendim të KB nr. 54, datë 30.11.2022 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2023”, shprehur ligjshmëria nga Prefektura e Qarkut Vlorë me shkresë Nr.1112/1 Prot., datë 12.12.2022.

Për vitin 2023, ardhurat totale të Bashkisë Delvinë, referuar të dhënave paraqiten me mos realizim në masën 71% ose nga vlera e parashikuar prej 62,518 mijë lekë është arkëtuar vlera 44,514 mijë lekë me një diferencë në shumën 18,004 mijë lekë. Pra nuk është realizuar 29% e planit, sipas të dhënave në aneksin nr. 2 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit,

Peshën kryesoren në planifikimin e të ardhurave e zë taksa mbi tokën bujqësore që është dhe burimi kryesorë që mund të gjenerohen të ardhura sipas bashkisë, e cila është parashikuar në vlerën 9,746 mijë lekë dhe realizuar në masën 39% e totalit të parashikuar. Referuar paketës fiskale të vitit 2022 taksa mbi tokën bujqësore është parashikuar në vlerën 19,252 mijë lekë dhe realizuar në masën 19% e totalit të parashikuar. Konstatohet se planifikimi i taksave sipas aneksit të

sipërcituar nuk është bërë mbi baza reale referuar diferencave në planifikim krahasuar dhe me vitin 2022.

Zë tjetër që ndikon në planifikim dhe mosrealizim është tarifa shërbime të tjera publike, e cila është parashikuar në masën 9,392 mijë lekë dhe realizuar në masën 72% ose me vlerë 6,760 mijë lekë. Veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimet e Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale, etj.

-Borxhi tatimor

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2023 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh në vlerën 15,077,970 lekë dhe me datë 31.12.2023 popullata për taksë toke, taksë ndërtese dhe tarifa vendore dhe të qirave, në vlerën gjithsej prej 52,938,976 lekë, **gjithsej në vlerën 68,016,302 lekë**. Referuar të dhënave të vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, konstatohet se, gjendja e debitorëve paraqitet si vijon:

Nr. debitorëve	Emërtimi njësie	Gjendja fund 31.12.2022	Pakesime 2023	Shtesa gjate vitit 2023	Gjendja në fund vitit 2023
231	BIZNESE				
199	B. Vogël Aktiv	11,185,361	1,794,116	2,364,886	11,756,131
32	B.Madh Aktiv	2,689,645	4,476,008	5,108,208	3,321,845
10963	FAMILJAR				
3542	Taksa e Tokës Bujqësore	29,528,062	3,772,540	6,864,221	32,619,743
5762	Taksa pastrimi, gjelberimi ,ndricimi	18,187,666	5,428,524	6,500,255	19,259,397
1659	Takse ndertese (objekt banimi)	1,029,230	777,552	807,508	1,059,186
		62,619,964	16,248,740	21,645,078	68,016,302

Burimi: Bashkia Delvinë

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se nivelimi detyrimeve të paarkëtuara (taksa. Tarifa vendore), vjen në rritje për vlerën 5,396,338 lekë, *ku nga vlera 62,619,964 lekë në fund të vitit 2022 në fund të vitit 2023 paraqiten në shumën 68,016,302 lekë*.

Nga të dhënat e pasqyrës, rezulton një gjendje e lartë e detyrimeve nga taksat e tarifave vendore, kjo për subjektet fizik/juridik dhe abonentë familjarë në vlerën **68,016,302 lekë**, e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar në buxhetin e bashkisë Delvinë, të cilët nuk mund t’i paraqesim në formë tabelore për shkak të sasisë së madhe, e cila është në formë dixhitale, me CD.

Referuar të dhënave nga Sektori i Taksave, Tarifave ,Lejeve dhe Licensave Bashkia Delvinë nuk është llogaritur penaliteti (kamatëvonesë), për mos likuidim në afat të detyrimeve.

Gjithashtu evidentohet një numër subjektësh të cilët dhe pse ushtrojnë aktivitet dhe nga Sektori i Taksave, Tarifave ,Lejeve dhe Licensave çdo vit ju rigjenerohet njoftim detyrimi për vitin vijues, janë lejuar që të ushtrojnë aktivitet pa bërë likuidimet e detyrimeve ndërvite.

Nga të dhënat evidentohet se një numër subjektësh me status pasiv/mbyllur paraqiten me situatë debitorë e cila paraqitet si vijon:

Nr. debitorëve	Emërtimi njësie	Gjendja fund 31.12.2022	Pakesime 2023	Shtesa gjate vitit 2023	Gjendja në fund vitit 2023
168	BIZNESE				
157	B. Vogël Pasiv	7,442,267			7,442,267
11	B.Madh Pasiv	2,522,975			2,522,975

Burimi: Bashkia Delvinë

Referuar sa më sipër nga strukturat e përgjegjëse të Sektorit të Taksave e Tarifave Vendore, nuk është ndërmarrë asnjë masë që parashikon dispozitat e ligjit për procedurat tatimore për arkëtimin e detyrimeve nga taksat e tarifave vendore, konkretisht

-Nuk gjen zbatim neni 89-Njoftimi dhe kërkesa për pagim të detyrimeve;

-Nenet 90-Urdhër bllokimit dhe 92-Masa për sigurimin e detyrimit tatimor, nuk janë bërë për të gjithë subjektet debitorë, duke lënë jashtë një pjesë të konsiderueshme të tyre, por dhe subjekte me detyrime nga viti në vit;

-Neni 93-Sekuestro dhe konfiskim i pasurisë dhe neni 94-Urdhër sekuestrimi, nuk gjen zbatim në asnjë moment, duke parë që një pjesë e subjekteve janë debitorë nga njëra periudhë në tjetër;

-Për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, nuk është kërkuar nga DTTV që për të gjithë subjektet të cilat janë njoftuar për pagesën e detyrimeve dhe zbatuar një pjesë e procedurave të kërkohej *kallëzim penal*, bazuar në nenin 181-Mos pagimi i taksave dhe tatimeve, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë

Nga auditimi rezulton se Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë dhe ALUIZNI-t. Sipas të dhënave të ardhurat nga ky zë janë realizuar **për vitin 2023** në masën 21% ose nga 4,310 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera 908 mijë lekë.

Mos realizimi vjen si rezultat i mos lëshimit të lejeve të ndërtimit në raport me planifikimin në fillim të periudhës.

Sipas të dhënave zyrtare që ASHK i ka dërguar Bashkisë Delvinë, konstatohet se deri më 31.12.2023, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 25 persona në vlera **807,508 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Delvinë. Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 2. Pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Veprimet apo mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje dhe Vendim të KB nr. 55, datë 30.11.2022.

Menaxhimi i taksës së ndërtesës (pasurisë)

Nga të dhënave të pasqyrës, rezulton se **për vitin 2023** është realizuar në masën 78%, ose nga 4,358 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera 3,383 mijë lekë.

Dokumentacioni në dosje është i paplotë. Megjithëse nga Sektori i të Ardhurave Vendore është vijuar me grup pune për evidentimin në terren të sipërfaqeve të banimit për efekt taks pasurie (taks ndërtesë), ky dokumentacion është i paplotë, pasi nuk evidentohet genplani për sipërfaqen e matur dhe në grupin e punës nuk ka asnjë specialist me profil inxhinier për kryerjen e matjeve faktike, ku te evidentohet sipërfaqja gjithsej, numri i kateve, lloji i aktivitetit ose destinacioni sipas kateve, etj.

Taksa e ndërtesës për subjektet/familjarët aplikohet në mungesë të dokumentacionit ligjorë (*genplani për sipërfaqet ose të dhënave nga ASHK*), duke përdorur tarifë fikse 100 m², mbi të cilën janë aplikuar taksa e pasurisë për ndërtesën. Kjo mënyrë e aplikimit të taksës së ndërtesës për abonentët familjarë nuk është e saktë dhe proporcionale, pasi favorizon disa dhe penalizon disa të tjerë, ku pas viteve 90 ka shumë ndërtime pa leje dhe me sipërfaqe mbi 100 m² (me 2 dhe 3 kate), dhe nuk janë identifikuar ato, duke bërë që ndaj këtyre subjekteve të mos aplikohet saktë taksa e ndërtesës.

Gjithashtu nuk ka një bashkëpunim midis vetë sektorëve të bashkisë dhe jo vetëm, ku mungon informacioni i marrë nga Drejtoria i PZHT për lejet e ndërtimit dhe certifikatës së përdorimit të lëshuar nga kjo strukturë për sipërfaqet e objekteve dhe sipërfaqet e truallit, megjithëse gjatë vitit

2023 ka vijuar bashkëpunimi, si dhe të dhënave të dërguara nga ASHK Dega Rajonale Sarandë mbi sipërfaqet e objekteve të legalizuara pa leje ndërtimi.

Veprime në kundërshtim me nenin 20, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Taksat vendore” i ndryshuar dhe neni 4 i VKM nr. 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

Konkluzion:

Nga auditimi i vjeljes së të ardhurave, rezultuan të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Delvinë në vlerën totale **68,823,810 lekë**.

1. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga subjektet e biznesit dhe familjare në vlerën **68,016,302 lekë**
2. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën **807,508 lekë**.

Për periudhën objekt auditimi, përgjegjësi mbajnë punonjësit e mëposhtëm:

- z. E.G, me pozicion ish Përgjegjës i Sektorit Taksave, Tarifave dhe Licencave për periudhën 01.01.2023 deri më 19.07.2023;
- z. G.L me pozicion Përgjegjës i Sektorit Taksave, Tarifave dhe Liçensave për periudhën 02.08.2023 e në vazhdim;

Përgjegjësi për vjeljen në kohë dhe administrimin e të ardhurave ka edhe kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas kërkesave të ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 42 “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 2, ku përcaktohet se:

“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa dhe është përgjegjës për mbledhjen në kohë të të ardhurave vendore.”

(Sa më sipër subjekti i audituar nuk ka paraqitur observacion mbi konstatimet dhe Projekt raportin grupit të auditimit deri në këtë fazë)

2 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike- Asetet.

I. Përshkrimi i situatës.

Auditimi u krye sipas programit të auditimit, pika 3. Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë. Nën-pikat:

3.1. Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht në, udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësite që varen prej tyre si dhe të njësite të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj”; udhëzimin e MF nr. 26, datë 27.12.2007, për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MF nr. 14, date 28.12.2006, dhe udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësite të Qeverisjes së Përgjithshme“, ndryshuar me udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022.

2.2. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;

2.3. Vlerësimi i arsyeshëm e i bazuar (në rastet kur vlerësimet janë të domosdoshme);

2.4. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të nën njësisë.

2.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike; Nënpika 2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë; Nënpika 3. Opinioni mbi pasqyrat financiare;

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Pasqyrat financiare të vitit 2023 të shoqëruar me formatet 1-8.

2. Dokumente kontabël si: ditarët e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj, centralizatori, bilanci vërtetues.

3. Dokumentacioni i kryerjes së inventarëve të aktiveve 2023, libri i aktiveve.

4. Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur për vitin 2023

6. Akt-rakordimet me Degën e Thesarit në mbyllje të vitit buxhetor 2023.

8. Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet “excel”si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet te ardhurat etj.).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

• *Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:*

Për vitin 2023 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Delvinë” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Delvinë si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestimi.

• *Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduar.*

Bashkia Delvinë për vitin 2023 ka hartuar Pasqyrat Financiare vetëm njësinë shpenzuese Bashkia Delvinë pasi nuk ka në varësi njësi të tjera shpenzuese.

• *Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare*

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Delvinë për vitin ushtrimor 2023 me shkresë përcjellëse nr. 385 prot., datë 16.02.2024 konfirmuar nga Dega e Thesarit Delvinë. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari Bashkisë Delvinë dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori i Financës.

• *Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.*

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

• *Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.*

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

• ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel”

- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitorë. Është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkaku e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

• ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2023 deri më datën 31.12.2023.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë**

tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2023 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Totali i Aktivit për vitin 2022 është në vlerën **1,174,267,920** lekë dhe për vitin 2023 është **1,198,998,450** lekë , i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari analitike paraqitet në aneksin nr. 1 pika 2 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Nga auditimi u konstatua se titullari i Bashkisë Delvinë ka nxjerrë Urdhrin e inventarizimit 2848, datë 15.12.2023, ku janë përcaktuar 5 (pesë) grupe me nga 3 (tre) anëtarë për inventarizimin e materialeve dhe aktiveve të trupëzuara për periudhën 01.01.2023-31.12.2023. Me përfundimin e procesit të inventarizimit nga komisionet , janë hartuar përmbledhëset e inventarëve, për llogarinë 218 “Inventarin ekonomik”, në vlerën 19,931,810 lekë, në llogarinë 327 “Inventarë i imët” në vlerën 30,112,336 lekë dhe llogarinë 312 “Materiale” në vlerën 1,097,273 lekë. Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore viti 2023, të pozicionit financiar Bashkia Delvinë; Formatit nr.1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme:

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2023, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si në vijim;

Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=1,051,363,580 lekë.

Aktivet 1,199,621,422 lekë

Pasivet 148,257,842 lekë

Aktivet neto 1,051,363,580 lekë

Aktivet afatshkurtra

Aktivet afatshkurta më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën **226,427,281 lekë** dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 57,933,999 lekë;

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 31,209,609 lekë;

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 137,283,673 lekë.

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
512	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	57,933,999	44,253,323	13,680,676
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	0	0	0
54	Akredeitiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provigjone zhvlerësimi	0	0	0
Totali		57,933,999	44,253,323	13,680,676

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 57,933,999 lekë, përbëhet nga: fondi i trashëguar nga transfertat e pakushtëzuar, sektoriale dhe të ardhurat e veta, gjendja e llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në shumën 46,959,830 lekë, gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 10,974,169 lekë.

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
--------------------	----------------------	-----------	-----------	---------------------

31	Materiale	1,097,273	1,937,113	-839,840
32	Inventar i imet	30,112,336	29,425,276	687,060
33	Prodhime, punime e shërbime ne proces			
34	Produkte			
35	Mallra			
36	Gjë e gjalle ne rritje e majmëri			
37	Gjendje te pambritura ose pranë të treteve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Shuma te parashikuara për zhvlerësim te inventarit(-)			
	Totali	31,209,609	31,362,389	-152,780

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Delvinë në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 31,209,609 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 1,097,273 dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 30,112,336 lekë.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën -152,780 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën -152,780 lekë.

Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 1,097,273 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	1,937,760
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	9,629,622.
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	10,469,462
Gjendja në 31.12.2023	1,097,273

Llogaria 327 “Objekte inventari”, ka vlerën 30,112,336 lekë. Lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2022	29,425,276
Hyrje gjatë vitit 2022	687,060
Dalje gjatë vitit 2022	0
Gjendja në 31.12.2022	30,112,336

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

- Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, paraqitet çelje për vitin 2023 në vlerën 84,397,894 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit të vitit 2023 paraqitet në vlerën 90,254,844 lekë, me rritje në vlerën 5,856,950 lekë. Në mënyrë analitike debitorët paraqiten në aneksin nr. 2 pika 2 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Nga Drejtoria e Financës është mbajtur në mënyrë analitike (sipas njësive të varësisë dhe listave emërore) llogaria 468, e cila në fund të vitit 2023 rezulton me një rritje prej 5,856,950 lekë. Nga verifikimi i kryer rezulton që totali i llogarisë analitike në fund të vitit 2023, kuadron me llogarinë sintetike në Aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar dhe me lëvizjet e llogarinë 468 të pasqyruara në Librin e Madh (Centralizatorin 2023).

Nga shuma prej 90,254,844 lekë debitorë në 31.12.2023, shuma prej 34,263,136 lekë, ose 37,96% të debitorëve e zënë debitorët e krijuar nga rekomandimet e lëna nga KLSH, për zhdëmtim dëmi për vitet 2016-2018.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 46,405,857 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 46,405,857 lekë. Vlera prej

47,028,829 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Në mënyrë analitike paraqitet:

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"	622,972
Llogaria 467 "Kreditor të ndryshëm"	33,953,817
Paga personeli llog 42	8,308,585
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	753,663
Sigurime shoqërore llog.435	2,435,719
Sigurime shëndetësore llog.436	331,101
Totali	47,028,829

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2022	65,170,601
Shtesa gjatë vitit 2022(D)	0
Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	18,141,772
Gjendja në 31.12.2022	65,170,601

Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 0 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2023	0
Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	0
Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	0
Gjendja në 31.12.2023	0

Nga auditimi rezultoi se llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" është paraqitur në vlerën 0 lekë, kjo në zbatim të Udhëzimit MFE nr. 5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" seksioni 3.1,

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Auditimi i aktiveve afatgjata materiale

Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. Kontrollë të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

- Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet **afatgjata materiale**;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:

a. Gjatë hyrjes se aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 5 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);

- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;

- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

b. Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Proçedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;

- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);

- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Aktivet Afatgjata jo materiale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe kërkime”, (kosto historike) në vlerën 0 lekë.

II. AKTIVET AFATGJATA

Në formatin nr. 1 “Aktivet Afatgjata” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e llog 23I “Investime”) në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 949,083,713 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 973,194,141 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,055,747,239 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,089,524,652 lekë që janë të pasqyruara sipas llogarive analitike.

Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” që përbëhet nga:

- **Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”** si në mbyllje të vitit 2022 dhe të vitit 2023 paraqitet në vlerën 0 lekë. Po kështu dhe sipas Formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 dhe 2023 me vlerë 0 lekë

-Analiza e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme, Qarkulluese dhe të tjera Aktive, llogaritë; 210, 211, 212, 213, 214, 215, 218, 31, 32, Viti 2023.

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) “Aktivet afatgjata materiale” paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e llog 23I “Investime”) në mbyllje të vitit 2022 vlerën 949,083,713 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 973,194,141 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,055,747,239 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,089,524,652 lekë që janë të pasqyruara sipas llogarive analitike.

U audituan gjendja analitike kontabël e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme dhe Qarkulluese për koston historike për llogaritë si vijon:

-Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 52,081,640 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 52,081,640 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 dhe vitit 2023 në të njëjtën vlerë prej 52,081,640 lekë.

Nr.	EMERTIMI	Vlera
1	Njësia Administrative Delvinë	51,936,640
	Varrezat publike	5,237,322

	Varrezat e qytetit	260,760
	Rrethimi I Zyrrave te Bashkisë	514,198
	Truall Ish Brigada Kembesorise Delvine	4,591,1360
2	Njësia Administrative Vergo	158,000
	Shuma	52,081,640

Llog 211 “Pyje, Kullota, Plantacione paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 4,500,000 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 4,500,000 lekë.

Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 dhe vitit 2023 në të njëjtën vlerë prej 4,500,000 lekë, e cila i përket Njesisë Administrative Vergo.

Kjo llogari kosto historike, paraqitet sipas të dhënave të inventarit në pasqyrën si më poshtë:

Nr.	EMERTIMI	Vlera
1	Njësia Administrative Vergo	4,500,000
	Shuma	4,500,000

-Llogaria 212 “Ndërtime konstruksione” paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 152,642,596 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 159,776,179 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 204,195,375lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 219,007,862 lekë me një diferencë në rritje prej 14,882,487 lekë përfaqësojnë shtesat e krijuara me pagesë si rezultat i investimit te kryer për rritjen e AQT në vlerën prej 13,812,487 lekë dhe i investimit pa pagese në objektin e Shkollës së Mesme “S.D” (palestra) nga R. Bank në vlerën 1,000,000 lekë. Kjo llogari paraqitet sipas të dhënave të inventarit në pasqyrën nr. 3 pika 2 bashkëlidhur raportit të auditimit.

-Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 726,670,950 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 745,072,876 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 726,670,950 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 745,072,876 lekë me një diferencë në rritje prej 18,401,926 lekë përfaqësojnë shtesat e krijuara me pagesë si rezultat i investimit te kryer për rritjen e AQT dhe pakesimit për 18,401,926ë. Kjo llogari kosto historike, paraqitet sipas të dhënave të inventarit në pasqyrën nr. 4 pika 2 bashkëlidhur raportit të auditimit.

-Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 5,631,426 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 5,689,537 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 12,074,110 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 12,494,110, lekë. Kjo llogari kosto historike, paraqitet sipas të dhënave të inventarit në pasqyrën nr. 5 pika 2 bashkëlidhur raportit të auditimit.

-Llogaria 215 “Mjete transporti” paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 6,702,230 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 5,361,784 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 36,436,354 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 36,436,354 lekë ,nuk ka patur ndryshim. Inventari i mjeteve të transportit në fund të vitit 2023 paraqitet në aneksin nr. 6 pika 2 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Nga auditimi i llogarisë 215 “Mjete transporti” në pasqyrat financiare është kontabilizuar vlera 36,436,354 lekë. Në këtë vlerë janë përfshirë edhe 6 automjete të tipeve të ndryshme me vlerë kosto historike 6,153,237 lekë të cilat nuk janë në gjendje pune dhe nuk ka vijuar procesi i nxjerrjes

jashtë përdorimit sipas propozimit të komisionit të miratuar me Urdhrin e inventarizimit 2848, datë 15.12.2023, të Kryetarit të Bashkisë. Në mënyrë të detajuar mjetet e dëmtuara paraqiten si më poshtë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi nr. 1, “Analiza, përbërja sipas klasave dhe trajtimi kontabël i llogarive të kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme (NJQP)”, 2.1, “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2”, vlera 6,153,237 lekë e cila i përket kostos historike mjete të dëmtuara duhej të debitohej në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”. Pra nga llogaria 215 “Mjete transporti” duhet të zbritet vlera e automjeteve të dëmtuara dhe të regjistrohesh në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”.

Inventari i mjeteve të transportit të dëmtuara në fund të vitit 2023

N R	E M E R T I M I	VLEFTA	TARGA E AUTOMJETIT	MARRËSI NË DORËZIM	GJËNDJE PUNE
1	Makina e pastrimit	803,025			jo
2	Makina e pastrimit	196,212			jo
3	Autovetura e administratës	1,475,000			jo
4	Makinatip "Xhip Hundaj" marka Galloper	1,480,000			jo
5	Automjeti "Marta Internacional"	700,000			jo
	Njësia Administrative Vergo				
6	-Xhip Foristrad	1,499,000			jo
	Shuma	6,153,237			

-Llogaria 218 “Inventar ekonomik” në datën 31.12.2022 është në vlerën 854,871 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 712,125 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 19,788,810 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 19,931,810 lekë në rritje për vlerën 143,000 lekë, e cila përfaqëson shtesat e vitit për blerje të ndryshme në vlerën 143,000 lekë .

Llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Delvinë në fund të vitit 2022, paraqitet në vlerën (106,663,526) lekë dhe në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën (166,330,511) lekë. Krahasuar me vitin 2022 llogaria 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” paraqitet me shtesë prej (9,666,985) lekë, shtesë e cila ka ardhur si rezultat i amortizimit të shtesave gjatë vitit ushtrimor. Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 7 pika 2 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimit MFE nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36.

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura nga Bashkia Delvinë, janë si më poshtë:

- ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5 %
- inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi) 20 %
- për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25%
- për mjetet e transportit 20%
- për aktivet afatgjata jo materiale (metoda lineare) 15 %

Llogaria 230 dhe 231 "Investime" për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale sipas të dhënave të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2023, paraqiten në vlerën 0 lekë. Në Pasqyrën statistikore nr. 6 "Investimet dhe burimi i financimit" shpenzimet për investime

paraqiten në shumën 33,777,413 lekë, nga të cilat Blerje krijuar me pagesë në vlerën 32,357,413 lekë dhe shtesa pa pagesë në vlerën 1,420,000 lekë.

Në mënyrë analitike shtesat për aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale paraqiten si më poshtë:

“Investime, llogaria analitike 231 viti 2023”

Nr.	Llogaria 212/Objekti	Vlerë
I	Blerje me pagesë	13,812,487
1	Banesa të komuniteteve të varfëra e në nevojë	11,685,076
	Shtepia e kultures	1,211,760
	Kopshti bajkaj	483,651
	Shkolla e mesme “S.Delvina”	432,000
II	Shtesë pa pagesë	1,000,000
1	Shkolla e mesme “S.Delvina”	1,000,000
	SHUMA 212	14,812,487

Nr.	Llogaria 213/Objekti	Vlerë
	Blerje me pagesë	18,401,926
1	Rruga Fushe Vërrri-Kalasë dhe Blerimas-Finiq	3,000,000
2	Rruga Shijan -Stjar-Bamatat	2,000,000
3	Rruga Bajkaj-Kopaçëz-Isak	1,671,696
4	Rruga Rusan-Vllahat	2,296,390
5	Rruga “Sinan Ballaci” Delvinë	188,228
6	Rruga “9 Tetori” Delvinë	4,811,772
7	Rruga “Lejla Malo” Delvinë	3,278,240
8	Ura e vanës	483,840
9	UKZ prane shkolles “S.Delvina”	671,760
	SHUMA 213	18,401,926

Nr.	Llogaria 214/Objekti	Vlerë
	Shtesë pa pagesë	420,000
1	Kosha mbeturinash 10kg	420,000
	SHUMA 214	420,000

Nr.	Llogaria 218/Objekti	Vlerë
I	Blerje me pagesë	143,000
1	Krijim laboratorit shtepia e kulturës	143,000
	SHUMA 218	143,000

3.Nënrubrika, aktive afatgjata financiare,

Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund të viti 2023 me vlerën 0 lekë dhe në fund të vitit 2022 në vlerën 0 lekë, siç shihet edhe në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të paraqitur më poshtë:

Nr. Reshti	Referenca e Llogarive	E M E R T I M I	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
59	25-26	3. Aktive Afatgjata Financiare	0	0
60	25	Huadhënie e Nënhuadhënie	0	0
61	26	Pjesmarrje në kapitalin e vet	0	0

Burimi: Bashkia Delvinë

Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se në çelje të vitit ushtrimor Bashkia Delvinë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si pjesëmarrëse me 100% të aksioneve të Klubit të Futbollit Delvinë si dhe 5.28% tek Shoqëria Rajonale e Ujësjetës Kanalizime Sarandë Sh.A me NUIS përkatëse L.....A dhe M.....U. Në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2022 dhe 2023, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, në kundërshtim me urdhrin e ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 28 “Investime në Pjesëmarrje” pika 35 ku citohet

“Një investim në një pjesëmarrje kontabilizohet në pasqyrat financiare individuale të investitorit në përputhje me paragrafët 37-42 të SNK 27 e cila thotë:

Kur përgatiten pasqyra financiare individuale, investimet në filiale, në njësitë ekonomike të kontrolluara bashkërisht dhe në sipërmarrjet që nuk janë klasifikuar si të mbajtura për shitje (ose të përfshira në grupin e nxjerrjes jashtë përdorimit që është klasifikuar si i mbajtur për shitje) në përputhje me SNRF 5 do të llogariten ose:

(a) me kosto, ose

(b) në përputhje me SNK 39.

Pasi referuar “Ekstraktit historik i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjekteve Shoqëri Aksionare” rezulton se më datë 03.05.2024 Bashkia Delvinë është 100% të aksioneve të Klubit të Futbollit Delvinë me vlerë nominale 465.000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 46,500,000 lekë dhe Shoqëria Rajonale e Ujësjetës Kanalizime Sarandë Sh.A me 5.28% të aksioneve me vlerë nominale 100.000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 5,280 lekë.

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Delvinë më 31.12.2022, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2022, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2022, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë		Viti 2022	Viti 2023	Diferenca/ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	2,452,037	622,972	-1,829,065
42	Detyrime ndaj personelit	7,239,386	8,308,585	1,069,199
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	823,106	753,663	-69,443
435	Sigurime shoqërore	2,119,359	2,435,719	316,360
436	Sigurime shëndetësore	288,129	331,101	42,972
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	11,166,533	10,974,169	-192,364
467	Kreditorë të ndryshëm	52,248,584	33,953,817	-18,294,767
4341	Të tjera operacione me shtetin (detyrime)	84,397,894	90,254,844	5,856,950
	Gjendja më fund të periudhës	160,735,028	147,634,870	-13,100,158

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit 2023 është në vlerën 622,972 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Delvinë më 31.12.2023. Lëvizja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në tabelën si më poshtë:

Llog. 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”	
Celje e vitit 2023	2,452,037
Shtesa (K)	10,485,155
Pakësime (D)	12,314,220
Gjendja në 31.12.2023 (K)	622,972

Gjendja e llogarisë 401-408“Furnitorë e llogari të lidhura me to” në shumën **622,972 lekë** përbëhet nga :

Nr.	E M E R T I M I	FATURA TATIMORE NUMER DHE DATE	SHUMA
1	A ShPK	Fat. nr. 4 Datë 17.01.2023	35,332
2	B.S	Fat. Nr. 165 Datë 20.11.2023	587,332
	SHUMA		622,972

- **Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”,** sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Delvinë, paraqitet në vlerën 8,308,585 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Llog. 42 "Detyrime ndaj personelit"	
Celje e vitit 2023	7,239,386
Shtesa (K)	99,014,726

Pakësime (D)	97,945,527
Gjendja në 31.12.2023(K)	8,308,585

Konkretisht, sipas dokumenteve të bankës të muajit Janar 2024, ka rezultuar:

Urdhër shpenzimi		Vlera	Urdhër shpenzimi		Vlera
Numër	Datë		Numër	Datë	
11	04.01.2024	220,307	21	04.01.2024	705,656
12	04.01.2024	1,042,027	22	04.01.2024	501,764
13	04.01.2024	1,571,648	23	04.01.2024	163,807
14	04.01.2024	122,780	24	04.01.2024	392,115
15	04.01.2024	1,105,239	25	04.01.2024	894,406
16	04.01.2024	565,895	26	04.01.2024	208,456
17	04.01.2024	83,489	27	04.01.2024	129,262
18	04.01.2024	172,324	28	04.01.2024	54,753
19	04.01.2024	129,538	33	08.01.2024	35,700
20	04.01.2024	158,419	34	08.01.2024	51,000
21	04.01.2024	705,656	Totali		8,308,585

- **Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”**, paraqitet në vlerën 753,663 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

Llog. 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"	
Çelje e vitit 2023	823,106
Shtesa (K)	5,669,144
Pakësime (D)	5,738,587
Gjendja në 31.12.2023 (K)	753,663

Konkretisht, sipas dokumenteve të bankës të muajit Janar 2024, ka rezultuar:

Urdhër shpenzimi		Vlera	Urdhër shpenzimi		Vlera
Numër	Datë		Numër	Datë	
1	04.01.2024	5,192	9	04.01.2024	4,550
2	04.01.2024	100,934	10	04.01.2024	160,026
3	04.01.2024	4,779	32	08.01.2024	217,268
4	04.01.2024	13,031	35	08.01.2024	116,309
5	04.01.2024	4,961	39	18.01.2024	42,045
7	04.01.2024	2,457	80	07.02.2024	22,726
8	04.01.2024	59,385	Totali		753,663

- **Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 2,435,719 lekë dhe 331,101 lekë.

Llog. 435 "Sigurime shoqërore"	
Çelje e vitit 2023	2,119,359
Shtesa	28,670,938
Pakësime	28,354,578
Gjendja në 31.12.2023	2,435,719
Llog. 436 "Sigurime shëndetësore"	
Çelje e vitit 2023	288,129
Shtesa	3,903,222
Pakësime	3,860,250
Gjendja në 31.12.2023	331,101

Konkretisht, sipas dokumenteve të bankës të muajit Janar 2023, ka rezultuar:

Urdhër shpenzimi		Vlera	Urdhër shpenzimi		Vlera
Numër	Datë		Numër	Datë	
1	04.01.2024	62,219	1	04.01.2024	8,634
2	04.01.2024	542,036	2	04.01.2024	75,234
3	04.01.2024	48,863	3	04.01.2024	6780
4	04.01.2024	39,259	4	04.01.2024	5,448

5	04.01.2024	58,882	5	04.01.2024	8,170
6	04.01.2024	131,221	6	04.01.2024	18,214
7	04.01.2024	291,601	7	04.01.2024	40,472
8	04.01.2024	223,673	8	04.01.2024	31,040
9	04.01.2024	36,996	9	04.01.2024	5,132
10	04.01.2024	951,121	10	04.01.2024	131,977
Totali		2,435,719	Totali		331,101

Llogaria 466 “Kreditore për mjete në ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Delvinë, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 10,974,169 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit Delvinë, sipas akt-akordimit datë 06.02.2024.

Llog. 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"	
Çelje e vitit 2023	11,166,533
Shtesa	669,034
Pakësime	861,398
Gjendja në 31.12.2022	10,974,169

Në mënyrë analitike sipas objekteve dhe vitit që i përket paraqitet në pasqyrën, në aneksin nr. 8 pika 2 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2023 paraqiten në shumën 34,576,789 lekë. Lëvizja e kësaj llogarie gjatë vitit 2023 paraqitet si më poshtë:

Llog. 467 "Kreditorë të ndryshëm"	
Çelje e vitit 2022	52,248,584
Shtesa	49,390,640
Pakësime	67,685,407
Gjendja në 31.12.2022	33,953,817

Këto vlera janë paraqitur në mënyrë analitike dhe përbëhen nga Fatura të palikujduara dhe vendime gjyqësore sipas pasqyrës aneksit nr. 9 pika 2 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit”, paraqitet me tepriçë kreditore në vlerën 46,959,830 lekë dhe paraqet rezultatin nga funksionimi. Ajo është e barabartë me vlerën e të ardhurave që Bashkia Delvinë trashëgon për t’u përdorur në vitin pasardhës sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me akt-rakordimin e mbajtur me degën e thesarit mbi fondet që trashëgohen.

Llog. 85 "Rezultati i ushtrimit"	
Çelje e vitit 2023	33,086,790
Shtesa(te ardhurat)	46,959,830
Pakësime	33,086,790
Gjendja në 31.12.2021	46,959,830

Pasqyra e Performancës financiare (F2)

Të ardhurat dhe shpenzimet, e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të Bashkisë Delvinë më datë 31.12.2023 janë të kuadruara me Degën e Thesarit Delvinë, konkretisht:

Rakordimi të ardhurave

Emërtimi	Vlera sipas Pasqyrës së Performancës	Dokumentimi	Vlera	Diferenca
----------	--------------------------------------	-------------	-------	-----------

-Të ardhurat e krijuara gjatë vitit	38,164,816	Akt-Rakordimi me Degen e thesarit 31.12.2023	38,164,816	0
-Granti nga buxheti	202,614,951		202,614,951	0
-Financim i pritshëm nga buxheti	46,405,857		46,405,857	0
-Fonde buxhetore të trashëguara	26,031,621		26,031,621	0
-Të ardhura të trashëguara (rez)	3,355,169		3,355,169	0
-Llog 73 Ndryshi i gjendjes Ome(+)-0				
Totali të ardhura	316,572,414		316,572,414	0

Rakordimi i Shpenzimeve

Emërtimi	Sipas Situacionit	Detyrimet e vitit 2022	Detyrime të vitit 2023	Sipas Pasyrës së Performancës
600	115,155,783	8,574,947	106,580,836	116,419,571
601	18,890,673	1,415,190	17,475,483	19,101,768
602	39,126,987	6,071,299	33,055,688	34,836,411
604	2,622,101	243,434	2,378,667	2,510,786
606	85,492,741	0	85,492,741	85,492,741
63				152,780
8423				-152,780
8421				5,157,452
8424				6,093,855
Totali	261,288,285	16,304,870	244,983,415	269,612,584

Diferenca në shumën 8,324,299 lekë midis shpenzimeve të paraqitura në Pasyrën e Performancës Financiare dhe sipas Situacionit përbëhet nga diferenca midis detyrimeve të muajit Dhjetor 2022 të paguara në vitin 2023 dhe detyrimeve të Dhjetorit 2023 të paguara në Janar 2024 e vijim në shumën 2,621,448 lekë, vlerës prej 152,780 lekë "Ndryshimi i gjendjes së inventarit" dhe si dhe vlerës prej 10,945,747 lekë nga operacione të korigjimit të rezultatit.

Në fund të vitit ushtrimor të dy llogaritë e klasës 6 "shpenzimet" dhe klasës 7 "të ardhurat", janë mbyllur duke debituar dhe kredituar respektivisht llogarinë 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore", konkretisht:

Rakordimi të ardhura, shpenzime dhe rezultati

	Emërtimi Burimi	Pasqyra	Situacioni	Diferenca
I	Totali të ardhura	316,572,414	316,572,414	0
II	Shpenzime	269,612,584	269,612,584	0
III	Rezultati i vitit ushtrimor	46,959,830	46,959,830	0
IV	Rezultati i vitit ushtrimor			

Në Pasyrën e Pozicionit Financiar, llogaria 85 "Rezultati nga veprimtaria" paraqitet në shumën 46,959,830 lekë, e njëjtë me Pasyrën e Performancës Financiare paraqitet në shumën 46,959,830 lekë.

Pasqyra e flukseve monetare (F3)

Pasqyra e Flukseve Monetare, paraqet rrjedhën e likuiditeteve dhe gjendjen më datë 31.12.2023.

Nr. Rubrike	PERMBAJTJA	Periudha Raportuse	Periudha Paraardhese
(b)	(c)	(1)	(2)
I	Veprimtarite e shfrytezimit	51,599,079	33,763,005
II	Veprimtarite e investimeve	11,492,262	11,962,535
III	Transferta e te tjera	-5,157,342	-1,472,217
VI	Teprica e Likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor	57,933,999	44,253,323

Nga kontrollet e kryera rezultoi se teprica e llogarisë së likuiditeteve më datë 31.12.2023, e paraqitur në këtë pasqyrë rezulton në shumën 57,933,999 lekë dhe kuadron me tepricën e

likuiditeteve të paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në Aktiv "Mjetet monetare dhe ekujvalentët e tyre" e cila paraqitet në shumën 57,933,999 lekë.

Plotësimi i Pasqyrës së Flukseve monetare është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 3.6 "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të flukseve monetare".

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4)

Numër llogarie	Emërtimi	Fonde bazë dhe grante kapitale	Rezultatet e mbartura	Rezultatet e ushtrimit	Gjithsej aktive neto/fonde neto
101	Aktivet neto	980,446,102			980,446,102
	Ndryshimet në aktivet neto	33,086,790	-33,086,790	23,957,648	23,957,648
105	Nga burime të brendshme Grante të brendshme kapitale Transferta të brendshme (grante në natyre)			33,624,633	33,624,633
1013	Nga kosumi i AAGJ			-9,666,985	-9,666,985
1015	Dalje jashtë përdorimi				
85	Nga rezultati i vitit ushtrimor	33,086,790	-33,086,790	46,959,830	46,959,830
Totali		1,013,532,892	-33,086,790	70,917,478	1,051,363,580

Nga verifikimi i kryer rezultoi se vlera totale e Aktiveve neto/fonde neto të paraqitura në "Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto", është e barabartë me vlerën e tyre të paraqitur në pasqyrën e "Pozicionit financiar", në shumën 1,051,363,580 lekë. Në këtë pasqyrë janë paraqitur saktë grantet bazë (çelja e vitit), rezultati i vitit të mëparshëm si dhe rezultatet e ushtrimit.

Vlera prej 70,917,478 lekë, përfaqëson gjithë shtesat e aktiveve neto/fonde neto gjatë vitit ushtrimor, të pasqyruara në të njëjtën vlerë edhe në Librin e madh në kredi të llogarisë 101 "Fonde bazë".

Vlera prej -9,666,985 lekë, përfaqëson amortizimin vjetor (shtesa)

Vlera prej 46,959,830 lekë, përfaqëson rezultatin financiar të vitit ushtrimor pasqyruar në llog.85. Nga auditimi rezultoi se fondet neto të pasqyruara në Pasqyrën "Ndryshimi në fondet neto/aktivet neto" në shumën 1,051,363,580 lekë kuadron me pasqyrimin e tyre në pasqyrën e "Pozicionit financiar".

Plotësimi i Pasqyrës së Aktiveve neto/Fonde neto është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 3.5 "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në Aktivet neto/Fondet neto".

Shënimet shpjeguese (Pasqyra F5):

Plotësimi i kësaj pasqyre është bërë në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 8, datë 03.09.2018, pika 3.7 "Rregullat për dhënien e shpjegimeve për pasqyrat financiare individuale". Nga Bashkia Delvinë është plotësuar Pyetësori dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore".

Pasqyrat statistikore

Pasqyra statistikore nr. 6 "Investimet dhe burimi i financimit"

Numër llogarie	Emërtimi	Vlera D	Vlera K	Teperica
	Shpenzimet për investime	33,777,413		
230	Shpenzime afatgjata jo materiale			
231	Spenzime Afatgjate materiale	32,357,413		
	Burimet për investime		33,777,413	
1050	Grante kapitale nga buxheti		32,357,413	
1051	Grante kapitale nga nivele të tjera			
1059	Grante të brendshme kapitale në natyrë	1,420,000	1,420,000	

11	Fonde të tjera të veta			
115	Caktim fondi për investime nga rezultati			
	Balanca	33,777,413	33,777,413	0

Vlera prej 32,357,413 përfaqëson shpenzimet për investime të cilat janë të rakorduara me Degën e Thesarit Delvinë.

Plotësimi i Pasqyrës së Statistikore “Investimet dhe burimi i financimit” është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 3.8.1 “Rregulla për plotësimin e pasqyrës statistikore të investimeve dhe burimeve të financimit të tyre”.

Pasqyra statistikore nr. 8 “Numri i punonjësve dhe Fondi i pagave”.

Në këtë pasqyrë është dhënë informacion mbi numrin e punonjësve, fondin e pagave, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe tatimin mbi të ardhurat.

Plotësimi i Pasqyrës së Statistikore “Numri i punonjësve dhe fondin e pagave” është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 3.8.4 “Rregulla për plotësimin e pasqyrës statistikore mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave”.

Sa më sipër për shkeljet e konstatuara ngarkohet me përgjegjësi znj. E.J me detyrë Drejtor i Financës pranë Bashkisë Delvinë.

Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve.

Bashkisë Delvinë, me VKM nr. 1691 datë 10.10.2007 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Delvinë, të Qarkut Vlorë”, i është miratuar lista inventarit me në total 26 prona, me VKM Nr.1265, datë 16.12.2009 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të Paluajtshme Publike Shtetërore, që Transferohen në Pronësi ose në përdorim të Bashkisë Delvinë, të Qarkut Vlorë” është miratuar lista përfundimtare me 283 prona. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me VKB Nr.29, datë 03.05.2012, ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Bashkisë Delvinë. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me Nr. 290 (dymijë e nëntëdhjetë) dhe përbëhet me 48(dyzete e tetë) fletë.

- VKM nr. 453 ,datë 09.07.2004 “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Delvinë, mjedise të Ish Brigadës së Këmësorisë dhe për një ndryshim të VKM nr.515 , datë 18.07.2003 Për miratimin e listës së inventarit të pronave “, Bashkisë Delvinë i janë transferuar 26 objekte me sipërfaqe ndërtese 7639 m² dhe sipërfaqe trualli 143.473m² me vlerë 2.537 mijë lekë sipas listas së inventarit.
- Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes nr 480 datë 30.07.2004 Bashkisë Delvinë i janë transferuar nga Brigada e Këmësorisë (Reparti Ushtarak 1900)prona sipas akt-dorëzimit të datës 02.09.2004.

Ish Komunës Vergo sot Njësia Administrative Vergo e Bashkisë Delvinë, me VKM nr. 433 datë 08.06.2016 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Vergo, të Qarkut Vlorë”, e ndryshuar me VKM nr.684, date02.09.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa ne vkm nr.433, date 08.06.2016 “Per trasferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe kullotave publike sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim te Ministrise se Mjedisit e Te Ish komunave/bashkive” i është miratuar lista inventarit me 416 prona .

Me VKM NR.59, date 26.01.2022 “Për miratimin e ndryshimit te statusit dhe te sipërfaqes së ekosistemeve natyrore Park Kombëtar (Kategoria II) të zonave të mbrojtura mjedisore”, VKM Nr. 60, 26.01.2022 “Për shpalljen e ekosistemeve natyrore Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror(Kategoria IV) si dhe miratimin e ndryshimit të statusit e të sipërfaqeve ekzistuese të zonave të mbrojtura mjedisore, që i përkasin kësaj kategorie”, kufijtë e zonave të mbrojtura kanë ndryshuar me shtim dhe reduktim të disa sipërfaqeve.

Aktualisht lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave është 391 prona të transferuara.

Me vendimin nr 510 datë 05.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara , arkivave për cdo dokumentacion në Njësitë e Qeversisjes Vendore , të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”si dhe urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr 52 datë 14.08.2015” është bërë marrja në dorëzim e aktiveve të trupëzuara .

Në mënyrë të përmbledhur pronat e kaluar me VKM paraqiten si më poshtë:

Nr.	Bashkia/ Njesite	Nr. Pronave në Inventar	Nr. i Praktikave të Certifikuara Deri Dhjetor 2022	Nr. Praktikave të Certifikuara 2023	Prona të pa Rregjistruara
1	Bashkia Delvinë	290	40	0	250
2	NJA.Vergo	416	0	2	414
	Total	706	40	2	664

Në mënyrë të detajuar paraqiten pronat të cilat janë aplikuar për regjistrim në ASHK për periudhën 31.12.2023 si vijon:

Nr	Emertimi i Pasurisë	Zona kadastral	Nr Pasurise	Siperfaqia sipas V.K.M.		Vertetim ose certifikate Hipoteke	Siperfaqia sipas Faktit	
				Trual 1	Ndert		Truall	Ndert
1	Godinë Ish Rep.Ushtarak 1900	1464	14/23		1034	Çertifikate Hipoteke		1034

Sa më sipër Bashkia Delvinë gjatë vitit 2023 nuk ka ngritur grupe pune për të bashkëpunuar me DVASHK Sarandë, në lidhje me regjistrimin e pronave sipas listës së aseteve të miratuara me VKM, për Bashkinë dhe Nj/Administrative si dhe nuk janë marrë masa për verifikimin e gjendjes faktike në terren, me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik dhe dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentet e pronësisë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit 20/20 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” datë 05.03.2020 nenin 37, ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr.10296 datë 07.08.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

(Sa më sipër subjekti i audituar nuk ka paraqitur observacion mbi konstatimet dhe Projekt raportin grupit të auditimit)

3 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme

3.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

3.2. Realizimi programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

3.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Për sa më poshtë në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 311/7 prot, datë 09.03.2023 i ka dërguar Bashkinë Delvinë, “Raportin përfundimtar”, për përmirësimin e gjendjes, janë rekomanduar zbatimin e masave të mëposhtme:

Verifikimi i zbatimi i rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur, paraqitet si më poshtë:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 10 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 10 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 2 masa, është zbatuar pjesërisht 1 masë, në proces zbatim 5 masa si dhe nuk janë zbatuar 2 masa*
- b. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara, janë rekomanduar 3 masa në vlerë 63,649 mijë lekë, të cilat janë pranuar plotësisht, është zbatuar një masë dhe janë në proces zbatimi 2 masa në vlerë 63,649 mijë lekë.*

DREJTIMET E AUDITIMIT:

1. Hartimi i programit (Plan veprimi) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, sic është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkin Delvinë rekomandimet e auditimi me shkresën e saj nr. 311/7 prot, datë 28.09.2023, ndërsa nga Bashkia Delvinë për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 2172/1 Prot. datë 18.10.2023. Pra përgjigja e Bashkisë Delvinë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë **brenda 20 ditësh**, pra brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes prej 20 ditësh. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Delvinë është hartuar Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 2172/2 Prot., datë 18.10.2023 dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

Zbatuar

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Delvinë, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 311/7 prot, datë 28.09.2023 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 28.03.2024.

Nga ana e Bashkisë Delvinë është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH me shkresën nr. 708 prot., datë 29.03.2024 sipas kërkesave të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30- Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika 2, ku përcaktohet se: Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Zbatuar

3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm, u konstatua se gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm nuk kuptohen dhe nuk funksionojnë, përgjatë gjithë strukturave të njësisë, pasi ky institucion nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

Mjedisi i kontrollit: Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsisve, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme. Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen. Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm. Nuk janë përcaktuar objektiva konkretë, të matshëm, për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme. Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të bashkisë në të cilin është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij

Menaxhimi i Riskut: Ka strategji të menaxhimit të riskut, si dhe regjistër risku, por procesi i Menaxhimit të Riskut për periudhën e auditimit rezulton të mos jetë realizuar dhe dokumentuar me vendimet përkatëse, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Kreu III dhe nenit 10, Kreu II, si dhe Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në bashki publike”. Në Bashkinë Delvinë, Drejtoria e administrimit të përgjithshëm, Sektori i financës dhe Sektori i tatim taksave nuk përdorin program për mbajtjen e kontabilitetit por operojnë me programin Excel ku niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë. Nuk ka asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Nuk është hartuar një regjistër kompleks për gjithë bashkinë, ku të identifikohen dhe të bëhet vlerësimi i risqeve për të gjitha Drejtoritë e NJA si dhe një plan-menaxhimi të risqeve në nivel bashkie për përcaktimin e veprimeve për të adresuar mangësitë. Regjistri i riskut dhe i plan-veprimit të menaxhimit të MFK nuk është i plotë dhe ka sjellë mosidentifikimin dhe mosvlerësimin e të gjitha risqeve të mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut. Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, rryshfetit dhe korrupsionit.

Aktivitetet e Kontrollit: Bashkia Delvinë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqsish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka ndarje të detyrave sipas funksionimit të sistemeve të IT, pasi ka vetëm një specialist IT, i cili duhet të menaxhojë dhe monitorojë gjithçka që ka lidhje me TI-në, etj.

Informimi dhe komunikimi: Sistemi i raportimit nuk ofron informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj. Mungojnë raportet periodike apo publikimet vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut. Në Rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit, por në fakt veprohet me komunikim verbal, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Monitorimi: Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Në Bashkinë Delvinë mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Në Bashkinë Delvinë aktivitetet e vlerësimit të njësive nuk janë në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e

Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të përfomancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave përshtatshme dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 21-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Delvinë dhe menaxherët kryesorë të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore. Për këtë më parë të kryhen trajnime për njohjen e Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe kërkesat e “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, për llojet e raporteve, frekuencën e raportimit me shkrim të Titullari nga secila drejtori/sector, etj. Të hartohet regjistri i riskut në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2. Nga verifikimi rezulton se Me shkresë nr. 2748 prot., datë 01.12.2023 është miratuar “Strategjia e Menaxhimit të Riskut për Bashkinë Delvinë”.

Me Urdhërin nr.491 , datë 01.03.2024, janë ngritur GMS dhe EMP për vitin 2024.

Me shkresë nr. 214, datë 25.01.2024 është miratuar “Regjistri i Riskut” nga titullari.

Nga Kryetari i Bashkisë ka dalë Udhëzimi i Brendshëm me nr.649, datë 25.03.2024 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027 për Bashkinë Delvinë.

Është miratuar nga titullari “Kalendari për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxheti Vjetor 2025 për Bashkinë Delvinë”.

Zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, në Bashkinë Delvinë nuk është krijuar Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe nuk ka funksionuar procesi i Auditimit të Brendshëm, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, etj. Nga auditimi nuk u konstatua asnjë procedurë për krijimin e kësaj njësie apo për rekrutimin e punonjësve për këtë strukturë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 21-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Delvinë dhe menaxhimi i lartë, të merren masa për të krijuar sa më parë Njësinë e auditimit të Brendshëm duke filluar procedurat e rekrutimit të punonjësve.

2.2. Rekomandimi: Nga menaxhimi i lartë i Bashkisë Delvinë, në koordinim me Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të shikohen mundësitë për lidhjen e një marrëveshjeje me strukturën e auditimit të brendshëm të njërit nga bashkitë e afërta, duke përdorur edhe praktikatat e ngjashme nga bashki të tjera.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.3. Nga verifikimi rezulton se Me Urdhërin nr.2361 Prot, datë 18.10.2023 të Kryetarit të Bashkisë Delvinë, është ngarkuar “Shefi i kabinetit” në bashkëbisedime për lidhjen e një Akt-Marëveshjeje për strukturën e Auditimit të Brendshëm. Deri në momentin e verifikimit nuk është nënshkruar asnjë aktmarveshje.

Pa zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga Auditimi u konstatua se midis vlerave të planit dhe zbatimit të buxhetit ka diferencë, përse i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre. Për vitin 2022, shpenzimet buxhetore janë planifikuar në vlerën 302,565 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 268,006 mijë lekë ose në masën 88.57%. Sipas burimeve të financimit për vitin 2022, nga transferata e pakushtëzuar (grandi) treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 154,294 mijë

lekë dhe janë realizuar në vlerën 131,146 mijë lekë ose në masën 85%. Nga këto, investimet janë realizuar në vlerën 15,377 mijë lekë nga 27,026 mijë lekë të planifikuara ose në masën 56.70%. Nga të ardhurat e trashëguara dhe të ardhurat e vitit, treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 72,783 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 37,861 mijë lekë ose në masën 52%. Nga këto, pagat janë realizuar në vlerën 19,255 mijë lekë nga vlera 19,756 mijë lekë të planifikuara ose në masën 97%, shpenzimet operative janë realizuar në vlerën 16,798 mijë lekë nga vlera 20,445 mijë lekë të planifikuara ose në masën 82% dhe investimet janë realizuar në vlerën 337 mijë lekë nga vlera 650 mijë lekë të planifikuara ose në masën 52%. Nga të dhënat e mësipërme, konstatohet se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit/planifikimit dhe zbatimit të shpenzimeve buxhetore, veçanërisht për zërat Investime (230+231) dhe shpenzime operative (602). Planifikimi i buxhetit nuk është real dhe i mbështetur në analizat e punës periodike apo konkluzionet e sakta për realizimet apo mosrealizimet e buxheteve paraardhëse të Bashkisë Delvinë. Po ashtu u konstatua se në buxhetin e vitit 2022, në planifikimin e shpenzimeve nuk është programuar si zë më vete shlyerja e detyrimeve për faturat e palikuiduara të vitit paraardhës, në vlerën 51,449,232 lekë. Sipas planit të shlyerjes dërguar në MFE me shkresën nr. 325 prot., datë 10.02.2022, është parashikuar që shlyerja në vitin 2022 të jetë 22,209,623 mijë lekë ose 43% e totalit. Për uljen e detyrimeve të prapambetura nuk janë bërë analiza për të nxjerrë konkluzione të sakta mbi krijimin apo akumulimin e detyrimeve të prapambetura dhe të krijohet një grafik duke zbatuar radhën e pagesave sipas nivelit të realizimit të të ardhurave. U konstatua se për vitin 2022 të ardhurat nga taksat e tarifave vendore gjithsej, nga 72,783 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 37,861 mijë lekë ose 52 %, me një mosrealizim në vlerën 34,922 mijë lekë. Kjo mungesë e të ardhurave do të ndikojë direkt në mosrealizimin e planifikuar të shërbimeve dhe të investimeve, prandaj është e nevojshme që nga Sektori i të Ardhurave të bëhet një analizë e hollësishme për të përcaktuar drejt ngarkesën fiskale për një planifikim real të të ardhurave, duke mos krijuar diferenca të dukshme si kjo e vitit 2022, me një nivel realizimi të ardhurash në masën 52%.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 30-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Delvinë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Shërbimeve Sociale dhe Arsimit në Bashkinë Delvinë, Sektorin e të ardhurave, të marrin masa në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse dhe të ardhurave fiskale. Të respektohet likuidimi me vonesë i faturave në tejkallim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe moslikuidimi i vlerës së plotë të faturës.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.2. Nga verifikimi rezulton se Me shkresën nr. 309 prot., datë 06.02.2024 i është dërguar Ministrisë së Financave, raporti i detyrimeve të prapambetura si dhe plani i shlyerjes për periudhën 3 vjeçare.

Zbatuar pjesërisht

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, ka rezultuar se nga 137 objekte inventari të pasurive të paluajtshme me kosto historike që i përkasin llogarive 210 “Toka troje terrene”, 211 “Pyje plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në vlerën 966,947,459 lekë, Bashkia Delvinë nuk posedon titull pronësie, në kundërshtim me VKM-në nr. 510, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pikat 1 dhe 2. Kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli III, pika 35.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 43-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Delvinë duhet të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023

4.2. Nga verifikimi rezulton se Me Urdhëri të Kryetarit të Bashkisë Delvinë nr. 2366 Prot, datë 18.10.2023. Drejtoria e Financës ka marrë masat duke planifikuar në Buxhetin e Bashkisë Delvinë të Vitit 2024, shpenzime për vlerësimin e pasurive të paluajtshme nga Ekspertë të jashtëm të liçensuar, me qëllim pajisjen sa më parë të këtyre pasurive me titull pronësisë. Shpenzime të cila janë miratuar me VKB nr 59 datë 22.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Delvinë për vitin 2023 dhe buxhetin afatmesëm për periudhën 2023-2025” ka miratuar buxhetin për të cilën është shprehur ligjshmëria e tij nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 2/1 prot, datë 11.01.2023.

Zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 2 raste u konstatua se OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DT të miratuara nga AK, në vlerën 7,884,282 lekë pa TVSH, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 53-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Delvinë, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, në shpalljen e OE fitues të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën risk real për shpenzimet e njësisë publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.2. Nga verifikimi rezulton se: Me urdhërin nr. 2367 Prot, datë 18.10.2023, të Kryetarit të Bashkisë Delvinë është ngarkuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), të prokurimeve publike, gjatë vlerësimit të ofertave në shpalljen e OE fitues të vlerësohej në maksimum kriteret DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE të cilët plotësojnë kriteret DST, përbën risk real për shpenzimet e njësisë publike.

Në process zbatimi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit “Objekt banimi 6 kat”, miratuar me Vendimin nr. 6, datë 12.11.2021, me zhvillues Enti Kombëtar i Banesave, në Bashkinë Delvinë, u konstatua se:

- Distanca ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës nuk janë respektuar sipas kriterëve të Rregullores së Zhvillimit të Territorit dhe Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Delvinë;
- Mungon dokumentacioni shoqëruar si dhe projektet teknike, që në tërësinë e tyre, përbëjnë projektin ndërtimor, siç janë relacioni teknik për projektin e mbrojtjes nga zjarri, studimi sizmik dhe gjeologjik, projekti i instalimeve të ngrohje-ftohjes, si dhe raporti i auditimit të efikasitetit energjetic;
- Koeficienti i shfrytëzimit të hapësirave publike (KSHP) dhe hapësirave për rrugë (KSHR) nuk është respektuar sipas kriterëve të Rregullores së Zhvillimit të Territorit, neni 40, pikat 2 dhe 4, si dhe Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Delvinë, nenet 39 dhe 40. Sipas përcaktimeve të

treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore DL_UB_A1_21/6, KSHR=10% dhe KSHP=20%, në këtë leje nuk ka asnjë parashikim për plotësimin e këtyre dy treguesve të zhvillimit;

- Përcaktimet ligjore në lidhje me numrin minimal të vendparkimeve nuk janë respektuar sipas kriterëve të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Delvinë, neni 43, “Kërkesat e parkimit”, pika 1. Në këtë leje nuk ka asnjë parashikim për plotësimin e numrit minimal të hapësirave për parkim. Vlen të theksohet se objekti nuk ka parashikuar kat nëntokësor ose mbi tokë, të dedikuar për parkim;

Sa më lart është në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 15, “Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi”, pika 1, nënpika ç); neni 32, “Kushtet bazë të zhvillimit në nivel njësie”; neni 35, “Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës”, neni 40, “Koefficientët e shfrytëzimit të tokës për rrugë dhe hapësira publike”, si dhe Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Delvinë, neni 45, “Treguesit e distancave”, pika 12, nenet 39 “Koefficienti minimal i shfrytëzimit të tokës për rrugë” dhe 40, “Koefficienti i shfrytëzimit të tokës për hapësira publike”. neni 43, “Kërkesat e parkimit”, pika 1.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 64-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Nga Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Delvinë, të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjisllacionit në fuqi:

- Në çdo rast, përpara nxejrrjes së certifikatave të përdorimit dhe çdo dokumenti apo akti tjetër administrativ, të verifikohet rast pas rasti dokumentacioni i ngarkuar në sistemin E-Leje nëse është në përputhje me kërkesat e legjisllacionit në fuqi. Në rast mangësish, të hartohen procesverbalet përkatëse dhe të informohen subjektet e interesuara.

- Të merren masa për të zbatuar dispozitat ligjore në lidhje me respektimin e parametrave urbanë, siç janë koefficienti i shfrytëzimit të territorit për rrugët dhe hapësirat publike, etj.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.2.Nga verifikimi rezulton se Me urdhërin nr. 2370 Prot., datë 18.10.2023, të Kryetarit të Bashkisë Delvinë është ngarkuar Sektori i Planifikimit Zhvillimit të Territorit si dhe dhe Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit për zbatimin e rekomandimit. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se IMTV ka përpiluar procesverbalin e Konstatimit të Kundërvajtjes me Nr. 0000011 Serie, datë 07.06.2023 si dhe ka marrë Vendimi Nr.7 për “Dënimin me Gjorbë” me Nr. 0000007 Serie, datë 12.06.2023 për subjektin juridik Enti Kombëtar i Banesave

Në process zbatimi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së miratimit të certifikatës së përdorimit për objektin “Ndërtesë me stil tradicional për aktivitet turistik me 2 kat + papafingo”, miratuar me Vendimin nr. 1, datë 20.01.2022, me subjekt zhvillues z. K B, me adresë Bajkaj, Delvinë, u konstatua se nuk janë respektuar kriteret ligjore në lidhje me listën e plotë të dokumentacionit që duhet dorëzuar për pajisjen me certifikatë përdorimi;

- Nga verifikimi në terren, e faktuar kjo edhe me dokumentacion fotografik, u konstatua se objekti i miratuar nuk është i njëjtë me objektin e ndërtuar.

Sa më lart është në kundërshtim me Ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 51 “Inspektimi”, pika 1, neni 52 “Kundërvajtjet administrative”, pika 5 dhe Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 1; si dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27/1 “Mbikëqyrja e punimeve” dhe neni 27/2 “Dokumentet për pajisjen me certifikatë përdorimi”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 64-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Nga Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Delvinë,

të merren masa për të respektuar dispozitat ligjore në lidhje me respektimin e listës së plotë të dokumentacionit që duhet dorëzuar përpara pajisjes me certifikatë përdorimi, sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar.

7.2. Rekomandimi: Bashkia Delvinë, Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, si dy struktura përgjegjëse për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme, por edhe për kontrollin e zbatimit të objekteve të ndërtuara me leje apo në shkëlqje të saj, në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga **kuadri ligjor në fuqi**, të marrin të gjitha masat për të mos miratuar asnjë certifikatë përdorimi kur ka ndryshime nga projekti i miratuar, deri në momentin e kryerjes të të gjitha ndryshimeve sipas projektit të miratuar. Gjithashtu, këto autoritete të marrin të gjitha masat e parashikuara në ligj për nisjen e procedurave disiplinore ndaj subjekteve të cilat kanë kryer kundërvajtjen, siç janë subjekti ndërtues, projektuesi, mbikëqyrësi dhe kolaudatori.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.3. Nga verifikimi rezulton se Me urdhërin nr. 2368 Prot., datë 18.10.2023, të Kryetarit të Bashkisë Delvinë është ngarkuar Sektori i Planifikimit Zhvillimit të Territorit si dhe dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit për zbatimin e rekomandimit. Sipas verifikimit në sistemin “e-leje” për vitin 2023 nuk është miratuar asnjë certifikatë përdorimi.

Në proces zbatimi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara Bashkisë Delvinë nga KLSH-ja me shkresën nr. 821 prot., datë 05.04.2023, rezultoi se:

- Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 14 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, 11 masa janë në proces zbatimi dhe 3 masa nuk janë zbatuar.

- Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara) janë dhënë 3 masa të cilat janë pranuar, në vlerën 44,779,581 lekë dhe janë në proces zbatimi.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7., faqe 70-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

Rekomandimi 3.1.: Kryetari i Bashkisë Delvinë, të marrë masa për ngritjen dhe miratimin në strukturën organizative të bashkisë Njësinë e Auditit të Brendshëm për kryerjen e funksioneve kontrolluese të veprimtarisë ekonomike financiare të kësaj njësie vendore. Në rast të mos plotësimit të kësaj strukturë me personel të kualifikuar, të shikohet mundësi e lidhjes së akt-marrëveshjes me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi, si Bashkia Sarandë ose Bashkia Dropull.

Nga verifikim rezulton se: Me Urdhërin nr.2361 Prot, datë 18.10.2023 të Kryetarit të Bashkisë Delvinë, është ngarkuar “Shefi i kabinetit” në bashkëbisedime për lidhjen e një Akt-Marëveshje për strukturën e Auditimit të Brendshëm.

Rekomandimi 9.1.: Kryetari i Bashkisë Delvinë të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve në proces ose të pazbatuara, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1110/7 datë 20.12.2021 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Delvinë”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre, *respektivisht:*

Nga verifikim rezulton se: Me Urdhërin nr. 2373 datë 18.10.2023 të Kryetarit të Bashkisë Delvinë, është ngarkuar “Shefi i kabinetit” për ndjekje dhe zbatim, për të cilën është hartuar dhe plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 2172/2 Prot., datë 18.10.2023

Rekomandimi 5.1.: Kryetari i Bashkisë Delvinë të marrë masa për ngritjen e një strukturë të veçantë për planifikimin vjetor të nevojave për karburant, bazuar në numrin e mjeteve, gjendjet teknike të tyre, normativave të harxhimit sipas katalogut ose me procesverbal argumentimi,

volumit të punës që kryhen në vitin paraardhës, sasi e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak.

Nga verifikim rezulton se: Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Delvinë nr.2368 Prot, datë 18.10.2023 dhe është ngritur struktura e veçantë për planifikimin vjetor në nevojave për karburant, bazuar në numrin e mjeteve , gjendjet teknike të tyre, normativave të harxhimit, të cilat janë miratuar në Këshillin Bashkiak me VKB nr.46 Prot, datë 22.12.2023.

Për uljen e borxhit tatimor.

Rekomandimi 1.1.: Sektori i të Ardhurave në Bashkinë Delvinë, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të periudhës në **vlerën 38,526,012 lekë.**

Menjëherë

Nga verifikimi rezulton se: Përsa i përket detyrimeve nga taksat dhe tarifatat vendore, gjendja debitore është trajtuar në auditimin aktual.

Në process zbatimi

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se programimi i të ardhurave nga tatimet taksat dhe tarifatat vendore, për vitin 2022, është me mosrealizim në vlerën 30,967 mijë lekë ose 45% e planit të miratuar. Detyrimet e papaguara total në progresiv nga viti 2011-2022 janë në shumën 62,619,964 lekë, ku vetëm për vitin 2022 janë evidentuar 6,431 mijë lekë, shumë e cila është e pakontabilizuar dhe përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Delvinë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 30-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Delvinë, të marrë masa ligjore ndaj subjekteve debitorë me qëllim mbledhjen e detyrimeve të prapambetura dhe të zbatojë procedurat ligjore për realizimin dhe arkëtimin e tyre.

1.1.2. Nga verifikimi rezulton se: Me urdhërin nr.2358 Prot, datë 18.10.2023 të Kryetarit të Bashkisë Delvinë është ngarkuar Drejtoria e Taksave, Tarifave dhe Lishencave për zbatimin e rekomandimeve. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se për vitin 2023 është likuiduar vlera 16,248,740 lekë. Më hollësisht trajtuar në akt konstatimin 2 të datës 03.05.2024.

Në process zbatimi

1.2. Rekomandimi: Nga Bashkia Delvinë, të merren masa për kontabilizimin dhe arkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore në momentin që lind detyrimi, me qëllim moskrijimin e detyrimeve të prapambetura dhe të ardhurave të munguara për secilën kategori biznesi.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2.1. Nga verifikimi rezulton se: Me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Delvinë nr. 2360 Prot, datë 18.10.2023 është ngarkuar Drejtoria e Financës, Shërbimeve Sociale dhe Arsimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave, Tarifave, Lejeve dhe Lishencave për ndjekin arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, që në momentin e lindjes së detyrimit të kryejnë kontabilizimin e tyre. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion Drejtoria e Financës për vitin 2023 ka bërë kontabilizimin e debitorve në llogarinë 468 “Debitor të ndryshëm”.

Zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programimit dhe realizimit të të ardhurave nga arkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë, u konstatua se nga Bashkia Delvinë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, nuk janë marrë masa të veçanta lidhur me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen. Sipas të dhënave zyrtare që ASHK i ka dërguar Bashkisë Delvinë, konstatohet se deri më 31.12.2022, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 30 persona, veprime dhe mosveprime jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 23 dhe pika 2 e nenit 27 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, sipas listës që disponon Bashkia, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Delvinë në vlerën 1,029,230 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Delvinë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 30-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të bëjë të mundur kontabilizimin dhe pasqyrimin e plotë të debitorëve. Të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë ndjekjen e hapave ligjore deri në arkëtimin e kësaj takse nga të gjithë individët e paraqitur si debitorë për vlerën 1,029,230 lekë sipas Aneksit A5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

2.2. Nga verifikimi rezulton se: Me urdhërin nr. 2362 Prot., datë 18.10.2023 është ngarkuar Drejtoria e Taksave, Tarifave, Lejeve dhe Lishencave, Sektori i Planifikimit, Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit. Me shkresën nr. 394/1 Prot, datë 19.02.2024 ka dalë urdhëri i Maturimit për kontabilizimin në bilancin e vitit pasardhës 2024. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion deri më datën 03.05.2024 është arkëtuar vlera 130,871 lekë duke ngelur pa u arkëtuar vlera 898,359 lekë.

Në proces zbatimi

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja c., Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 58 “Llojet e masave disiplinore”, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Delvinë, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

1. Vërejtje me paralajmërim për z. K.M, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Nga verifikimi rezulton se me urdhërin nr. 2375 Prot, datë 18.10.2023 është ngritur komisioni “Për dhënien e masës disiplinore”, ku në përfundim ka procedurës ka vendosur mas disiplinore “Vrejtje” për z. K.M, Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit të Territorit sipas Vendimit nr. 2375/4, datë 06.11.2023.

2. Vërejtje për z. A.TH, me detyrë specialist ndërtimi pranë Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Nga verifikimi rezulton se me vendimin nr.1556/1 Prot, datë 18.07.2023 ka ndërprer mardhëniet financiare me Bashkinë Delvinë.

3. Vërejtje për z. E.G, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ardhurave Vendore, për periudhën 01.01.2022-31.12.2022. Nga verifikimi rezulton se me vendimin nr.1564/1 Prot, datë 19.07.2023 ka ndërprer mardhëniet financiare me Bashkinë Delvinë.

Zbatuar

E.NJOFTIM PËR DEPARTAMENTIN E ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIN PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Delvinë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

- a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.
- b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Nga verifikimi rezulton se Drejtoria e Burimeve Njerëzore me shkresën Nr.2375/5 prot., datë 22.12.2023, ka njoftuar Departamentin e Administratës Publike për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

Zbatuar

- Konkluzione dhe rekomandime:

Në përfundim të procesit të auditimit, duke vlerësuar punën e bërë nga Bashkia Delvinë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 311/7 prot, datë 09.03.2023, për masat të cilat janë cilësuar në proces zbatimi rikërkohet vazhdimi i procedurave dhe për masat e pa zbatuara ose zbatuar pjesërisht KLSH rikerkon zbatimin e plotë të rekomandimeve, si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Delvinë 10 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 10 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 2 masa, është zbatuar pjesërisht 1 masë, në proces zbatim 5 masa si dhe nuk janë zbatuar 2 masa si vijon:

2.1. Rekomandimi: Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Delvinë dhe menaxhimi i lartë, të merren masa për të krijuar sa më parë Njësinë e auditimit të Brendshëm duke filluar procedurat e rekrutimit të punonjësve.

2.2. Rekomandimi: Nga menaxhimi i lartë i Bashkisë Delvinë, në koordinim me Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të shikohen mndësitë për lidhjen e një marrëveshjeje me strukturën e auditimit të brendshëm të njëres nga bashkitë e afërta, duke përdorur edhe praktikatat e ngjashme nga bashki të tjera.

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Delvinë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Shërbimeve Sociale dhe Arsimit në Bashkinë Delvinë, Sektorin e të ardhurave, të marrin masa në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe

shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse dhe të ardhurave fiskale. Të respektohet likuidimi me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe moslikuidimi i vlerës së plotë të faturës.

Menjëherë

IV GJETJE DHE REKOMANDIME

A- MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta paraqitet në vlerën 235,807 mijë lekë, ndërsa realizimi 188,847 mijë lekë, ose në masën 80.09%. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën 31,831 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 20,673 mijë lekë, ose në masën 64.95 %, e cila vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Delvinë në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën .1, faqe 11-18, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Sektori i Financës, në bashkëpunim me Ekipet e Menaxhimit të Programeve, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme, si dhe të rishikuar përgjatë vitit, mbi bazë nevojash dhe mundësish realizimi, si për investimet ashtu edhe për shpenzimet për mallra e shërbime.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Bashkia Delvinë në datën 01.01.2023 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 49,022 mijë lekë e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Në planin e buxhetit vjetor 2023 është planifikuar për likuidim gjatë këtij viti vlera 5,501 mijë lekë, nga e cila është likuiduar vlera 20,035 mijë lekë, ose 364% e vlerës së planifikuar. Vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2023), është ulur (49,022-32,753), me 16,268 lekë, ose në masën prej 33%. Për sa më sipër rezulton se marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. Për mos marrjen e masave të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe krijimi i detyrimeve të reja për vitin 2023 paraqiten në aneksin nr. 1 pika 1.4 bashkëlidhur raportit të auditit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 10-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Delvinë dhe Sektori i Financës, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të

përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

Menjëherë

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se për vitin 2023, të ardhurat totale të Bashkisë Delvinë, paraqiten me mos realizim në masën 71%, ku nga vlera e parashikuar prej 62,518 mijë lekë është arkëtuar vlera 44,514 mijë lekë, pra 18,004 mijë lekë më pak.

Peshën kryesoren në planifikimin e të ardhurave e zë taksa mbi tokën bujqësore që është dhe burimi kryesorë që mund të gjenerohen të ardhura sipas bashkisë, e cila është parashikuar në vlerën 9,746 mijë lekë dhe realizuar në masën 39% e totalit të parashikuar. Referuar paketës fiskale të vitit 2023 taksa mbi tokën bujqësore është parashikuar në vlerën 19,252 mijë lekë dhe realizuar në masën 19% e totalit të parashikuar. Konstatohet se planifikimi i taksave sipas aneksit të sipërcituar nuk është bërë mbi baza reale referuar diferencave në planifikim krahasuar dhe me vitin 2022.

Zë tjetër që ndikon në planifikim dhe mosrealizim është tarifa shërbime të tjera publike, e cila është parashikuar në masën 9,392 mijë lekë dhe realizuar në masën 72% ose me vlerë 6,760 mijë lekë. Veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimet e Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale, etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën .1, faqe 18-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Sektori i Taksave, Tarifave, Lejeve dhe Licensave në Bashkinë Delvinë të marrë masa që të bëjë një analizë të hollësishme për planifikimin sa më real të të ardhurave për të mos krijuar diferenca të dukshme me realizimin e shpenzimeve buxhetore.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i paketës fiskale për vitin 2023 rezulton se planifikimi i të ardhurave nga taksa e ndërtesë nuk është i saktë, megjithëse nga Sektori i të Ardhurave Vendore është vijuar me grup pune për evidentimin në terren të sipërfaqeve të banimit për efekt taks pasurie (taks ndërtese), ky dokumentacion është i paplotë, pasi nuk evidentohet genplani për sipërfaqen e matur dhe në grupin e punës nuk ka asnjë specialist me profil inxhinier për kryerjen e matjeve faktike, ku të evidentohet sipërfaqja gjithsej, numri i kateve, lloji i aktivitetit ose destinacioni sipas kateve, etj. në këto kushte taksa e ndërtesës për subjektet/familjarët aplikohet në mungesë të dokumentacionit ligjorë *(genplani për sipërfaqet ose të dhënave nga ASHK)*, duke përdorur tarifë fikse 100 m², mbi të cilën janë aplikuar taksa e pasurisë për ndërtesën. Kjo mënyrë e aplikimit e taksës së ndërtesës për abonentët familjarë nuk është e saktë dhe proporcionale, pasi favorizon disa dhe penalizon disa të tjerë, ku pas viteve 90 ka shumë ndërtime pa leje dhe me sipërfaqe mbi 100 m² (me 2 dhe 3 kate), dhe nuk janë identifikuar ato, duke bërë që ndaj këtyre subjekteve të mos aplikohet saktë taksa e ndërtesës.

Gjithashtu nuk ka një bashkëpunim midis vetë sektorëve të bashkisë dhe jo vetëm, ku mungon informacioni i marrë nga Drejtoria i PZHT për lejet e ndërtimit dhe certifikatës së përdorimit të lëshuar nga kjo strukturë për sipërfaqet e objekteve dhe sipërfaqet e truallit, megjithëse gjatë vitit 2023 ka vijuar bashkëpunimi, si dhe të dhënave të dërguara nga ASHK Dega Rajonale Sarandë mbi sipërfaqet e objekteve të legalizuara pa leje ndërtimi.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 20, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Taksat vendore” i ndryshuar dhe neni 4 i VKM nr. 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës. *(Më*

hollësisht trajtuar në pikën .1, faqe 18-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1.Rekomandimi: Sektori i Taksave, Tarifave, Lejeve dhe Licensave në Bashkinë Delvinë, të marrë të gjitha masat për një bashkëpunim më të mirë me Drejtorinë e PZHKT Bashkia Delvinë dhe ASHK Dega Rajonale Sarandë, për sigurimin e të dhënave të nevojshme me dokumentacion ligjor për sipërfaqet e ndërtimit të objekteve, kjo për një taksim sa më real të taksës së pasurisë (ndërtesës), si dhe të vijojë puna me grupe pune në mungesë të informacionit zyrtarë për evidentimin në terren të sipërfaqeve të ndërtimit për taksën e pasurisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare 2023, rezulton se llogaria 215 “*Mjete transporti*” paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 6,702,230 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 5,361,784 lekë. Nga analiza e llogarinë 215 “*Mjete transporti*” në pasqyrat financiare është kontabilizuar me kosto historike 36,436,354 lekë, në të cilën është përfshirë edhe vlera 6,153,237 lekë për 6 automjete të tipeve të ndryshme të cilat nuk janë në gjendje pune dhe nuk ka vijuar procesi i nxjerrjes jashtë përdorimit sipas propozimit të komisionit të miratuar me Urdhrin e inventarizimit nr. 2848, datë 15.12.2023, të Kryetarit të Bashkisë, në zbatim të Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi nr. 1, “Analiza, përbërja sipas klasave dhe trajtimi kontabël i llogarive të kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme (NJQP)”, 2.1, “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2”, vlera 6,153,237 lekë e cila i përket koston historike mjete të dëmtuara duhej të debitohej në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 23-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës në pasqyrat e vitit 2024 të bëjë sistemimin e vlerës 6,153,237 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të 6 automjeteve të dëmtuar në llogarinë 215 “*Mjete transporti*”, sistemi të kryhet referuar trajtimin kontabël në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2024

6.Gjetje nga auditimi: Nga analiza e llogarisë 26 “*Aktive afatgjata financiare*” rezulton se në çelje të vitit ushtrimor Bashkia Delvinë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si pjesëmarrëse me 100% të aksioneve të Klubit të Futbollit Delvinë me vlerë nominale 465.000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 46,500,000 lekë si dhe 5.28% tek Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Sarandë Sh.A me NUIS përkatëse me vlerë nominale 100.000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 5,280 lekë. Në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2022 dhe 2023, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, në kundërshtim me urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 28 “Investime në Pjesëmarrje” pika 35 ku citohet “*Një investim në një pjesëmarrje kontabilizohet në pasqyrat financiare individuale të investitorit në përputhje me paragrafët 37-42 të SNK 27*”(Më hollësisht trajtuar në pikën .2, faqe 23-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1.Rekomandim: Nëpunësi Zbatues, të marrë masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% të aksioneve të Klubit të Futbollit Delvinë me vlerë nominale 465.000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 46,500,000 lekë dhe Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Sarandë Sh.A me 5.28% të aksioneve me vlerë nominale 100.000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 5,280 lekë, në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet, deri në transferimin përfundimtar të aksioneve dhe marrjes në dorëzim të tyre.

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës rezulton se Bashkisë Delvinë, me VKM nr. 1691 datë 10.10.2007 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Delvinë, të Qarkut Vlorë”, i është miratuar lista inventarit me në total 26 prona. Me VKM Nr.1265, datë 16.12.2009 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të Paluajtshme Publike Shtetërore, që Transferohen në Pronësi ose në përdorim të Bashkisë Delvinë, të Qarkut Vlorë” është miratuar lista përfundimtare me 283 prona, miratuar me VKB Nr. 29, datë 03.05.2012, e cila fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me Nr. 290 (dymijë e nëntëdhjetë) dhe përbëhet me 48(dyzetë e tetë) fletë. Me VKM nr. 453, datë 09.07.2004 “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Delvinë, mjedisë të Ish Brigadës së Këmbësorisë dhe për një ndryshim të VKM nr.515 , datë 18.07.2003 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave”, Bashkisë Delvinë i janë transferuar 26 objekte me sipërfaqe ndërtese 7639 m² dhe sipërfaqe trualli 143.473m² me vlerë 2.537 mijë lekë sipas listës së inventarit. - Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes nr. 480 datë 30.07.2004 Bashkisë Delvinë i janë transferuar nga Brigada e Këmbësorisë (Reparti Ushtarak 1900)prona sipas akt-dorëzimit të datës 02.09.2004.

-Lista e pyjeve dhe kullotave është transferuara me VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/ bashkive”, ndryshuar me VKM nr. 684 datë 02.09.2020 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike” sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të Ish komunave/bashkive” i është miratuar lista inventarit me 416 prona. Me VKM NR.59, date 26.01.2022 “Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore Park Kombëtar (Kategoria II) të zonave të mbrojtura mjedisore”, VKM Nr. 60, 26.01.2022“Për shpalljen e ekosistemeve natyrore Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror(Kategoria IV) si dhe miratimin e ndryshimit të statusit e të sipërfaqeve ekzistuese të zonave të mbrojtura mjedisore, që i përkasin kësaj kategorie”, kufijtë e zonave të mbrojtura kanë ndryshuar me shtim dhe reduktim të disa sipërfaqeve. Aktualisht lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave është 391 prona të transferuara. Me vendimin nr. 510 datë 05.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara , arkivave për çdo dokumentacion në Njësitë e Qeverisjes Vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial” si dhe urdhrin të Kryetarit të Bashkisë nr. 52 datë 14.08.2015” është bërë marrja në dorëzim e aktiveve të trupëzuara .

Bashkia Delvinë gjatë vitit 2023 nuk ka ngritur grupe pune për të bashkëpunuar me DVASHK Sarandë, në lidhje me regjistrimin e pronave sipas listës së aseteve të miratuara me VKM, për Bashkinë dhe Nj/Administrative, si dhe nuk janë marrë masa për verifikimin e gjendjes faktike në terren, me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik dhe dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentet e pronësisë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit 20/20 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” datë 05.03.2020 nenin 37, ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr.10296 datë 07.08.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. (Më hollësisht trajtuar në pikën.2, faqe 23-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Delvinë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për identifikimin e gjendjes dhe numrit të aseteve të cilat i janë transferuar në pronësi në mënyrë përfundimtare, si dhe të fillohet përgatitja e dokumentacionit tekniko ligjor të secilit prej tyre për të vijuar me aplikimet përkatëse për pajisje me çertifikatë pronësie.

Menjëherë dhe në vijimësi

A.1. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM.

8.Gjetje nga auditimi Në përfundim të procesit të auditimit, duke vlerësuar punën e bërë për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 311/7 prot, datë 09.03.2023 në bashkinë Delvinë, konstatohet se nga kryetari i bashkisë nuk janë ndërmarr të gjitha procedurat për zbatimin e rekomandimeve si vijon:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 10 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 10 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 2 masa, është zbatuar pjesërisht 1 masë, në proces zbatim 5 masa si dhe nuk janë zbatuar 2 masa

b. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara, janë rekomanduar 3 masa në vlerë 63,649 mijë lekë, të cilat janë pranuar plotësisht, është zbatuar një masë dhe janë në proces zbatimi 2 masa në vlerë 63,649 mijë lekë.

Sa më sipër veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1 faqe 38-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1.Rekomandim: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

Për 3 masa organizative të cilat janë konsideruar të pa zbatuara ose zbatuar pjesërisht, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

2.1. Rekomandimi: Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Delvinë dhe menaxhimi i lartë, të merren masa për të krijuar sa më parë Njësinë e auditimit të Brendshëm duke filluar procedurat e rekrutimit të punonjësve.

2.2. Rekomandimi: Nga menaxhimi i lartë i Bashkisë Delvinë, në koordinim me Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të shikohen mundësitë për lidhjen e një marrëveshjeje me strukturën e auditimit të brendshëm të njëres nga bashkitë e afërta, duke përdorur edhe praktikatat e ngjashme nga bashki të tjera.

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Delvinë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Shërbimeve Sociale dhe Arsimit në Bashkinë Delvinë, Sektorin e të ardhurave, të marrin masa në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse dhe të ardhurave fiskale. Të respektohet likuidimi me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve të kryera nga llogaria 602 konstatohet se është kaluar edhe kontributi për shoqëritë tregtare për Klubin Shumë sportesh në vlerën 6,000 mijë lekë për gjithë vitin 2023 miratuar me vendimin nr. 59 datë 22.12.2022. Ky kontribut lind nga zotërimi i aksioneve që Bashkia Delvinë ka në këtë shoqëri.

Bashkia Delvinë nga ana e sajë nuk ka filluar procedurat për shitjen e aksioneve të shoqërisë “Klubi i Futbollit Delvina” sha në përputhje me ligjin nr. 105/2020, datë 29.07.2020 “Për Sportin”, neni 8 ku citohet “Institucionet publike qendrore dhe vendore, që kanë në zotërim aksione të shoqërive tregtare sportive, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji i nxjerrin ato në shitje në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.”. Nga mos zbatimi i këtij

ligji, nga Bashkia Delvinë është vijuar me planifikimin dhe kryerjen e pagesave si kontribut në vlerë totale 6,000 mijë lekë ndaj “Klub Futbollit Delvina”, që përbën shpenzim pa ekonomikitet i fondeve të buxhetit të shtetit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2. faqe 11-18, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Bashkia Delvinë të marrë masa të nxjerrë në shitje aksionet që zotëron në shoqërinë “Klubi i Futbollit Delvina”, sha në përputhje me parashikimet e ligjore “Për Sportin”.

Menjëherë

C.I. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA - TË ARDHURA TË MUNGUARA.

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datë 31.12.2023 gjendja e debitorëve nga taksat e tarifave vendore për subjektet fizik/ juridik dhe abonentë familjarë paraqitet në shumën 68,016,302 lekë, nga e cila subjektet në vlerën 15,077,970 lekë dhe abonentë familjarë në vlerën 52,938,976. Niveli i detyrimeve të paarkëtuara në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022 vjen në rritje për vlerën 5,396,338 lekë, ku nga vlera 62,619,964 lekë në fund të vitit 2022 dhe në fund të vitit 2023 paraqiten në shumën 68,016,302 lekë. Vlerë e cila është kontabilizuar në pasqyrat financiare. Referuar të dhënave nga Sektori i Taksave, Tarifave, Lejeve dhe Licensave Bashkia Delvinë nuk është llogaritur penalteti (kamatëvonesë), për mos likuidim në afat të detyrimeve. *Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni nenet 15 dhe 181. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 18-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

1.1.Rekomandimi: Sektori i Taksave, Tarifave, Lejeve dhe Licensave në Bashkinë Delvinë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifave vendore në fund të vitit 2023 në vlerën **68,016,302 lekë**.

Brenda datës 31.12.2024

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë (ALUIZNI-t) nga ndërtimet informale., konstatohet se deri më 31.12.2023, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 25 persona në vlera **807,508 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Delvinë. Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 2. Pika 2.6 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Veprimet apo mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje dhe Vendim të KB nr. 55, datë 30.11.2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 18-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim, Kontroll Territorit në bashkëpunim me Sektorin e Taksave, Tarifave, Lejeve dhe Licensave në Bashkinë Delvinë, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **807,508 lekë**.

Brenda datës 31.12.2024

D. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave

për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Delvinë t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

